# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6016
E mërkurë, 4 mars 2020
çmimi 0.40 €


## Presidenti kërkon të raportojë në Kuvend për takimin me Vuçiqin
FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS, GLAUK KONJUFCA, KA PROPOZUAR TËRHEQJEN NGA MISIONET DIPLOMATIKE TË GJASHTË AMBASADORËVE FAQE 4-5

## Në mesin e propozimeve për tërheqje, edhe

# AMBASADORJA MË DINJITOZE QË KA PASUR KOSOVA






Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka propozuar tërheqjen nga misionet diplomatike të gjashtë ambasadorëve dhe një konsulli. Personat e propozuar për tërheqje nga misionet diplomatike janë: Vlora Çitaku (Uashington), Edon Cana (Sofje), Lirim Grejçevci (Hagë), Shpend Kallaba (Budapest), Mimoza Ahmetaj (Strasburg), Ylber Hysa (Podgoricë) dhe Ramadan Avdiu (konsull në Gjenevë). Ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, ka thënë se do ta respektojë kërkesën e Qeverisë së Kosovës. "Mua më mjafton fakti tashmë i ditur botërisht, se unë jam e padëshiruar. Megjithatë, besoj se e kam merituar një konsultim paraprak lidhur me propozimin në fjalë. Nuk ka ambasador të përjetshëm. E përjetshme është vetëm Kosova dhe shërbimi për të", ka thënë Çitaku pas marrjes së lajmit për tërheqje nga misioni diplomatik

## NË KOSOVË U TESTUAN 42 RASTE ME KORONAVIRUS, POR REZULTATET DOLËN NEGATIVE
FAQE 7

## Kurti kërkon ndihmë nga ShBA-ja për ndaljen e çnjohjeve nga Serbia
FAQE 3



### OPINION

**GRENELLI AGRESIV, THAÇI POSESIV, VUÇIQI FITUES DHE ALBIN KURTI SFIDUES!** F. 11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



### AKTUALE



**RAHOVECI, MITROVICA DHE PRISHTINA, KOMUNAT MË TRANSPARENTE PËR VITIN 2019** F. 6

**MINISTRI REKA: INTEGRIMI EVROPIAN ËSHTË DETYRË E TË GJITHËVE** F. 5

### EKONOMI

**ATK-ja VETËM PËR DY MUAJ MBLODHI RRETH 98 MILIONË EURO** F. 8

**AUDITORI I PËRGJITHSHËM THOTË SE AUDITIMI I FONDIT ZHVILLIMOR TË MIRËBESIMIT ISHTE SFIDË** F. 8

### KULTURË

**AKUZA E NJË GRUAJE INTELEKTUALE** F. 18

Mehmet HAJRIZI

### SPORT

**BALLKANI - DITA 'LUFTOJNË' PËR POZITËN E PARË** F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
044/256-051
044/367-061
028/532-617
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Engel: Problemi kryesor për Kosovën është Serbia, jo tarifa



**Prishtinë, 3 mars** - Kongresisti amerikan Eliot Engel thotë se me të vërtetë mendoj se është e padrejtë për BE-në dhe të tjerët të flasin për tarifën sikur ajo të jetë arsyeja që po shfaqen problemet. Ai ka thënë se tarifa nuk është problemi, problemi është Serbia, dhe askush nuk drejtohet kah Serbia, për t'i treguar se ajo nuk mund të vazhdojë të bëjë gjëra të tilla. "Kështu, nëse Serbia do ta ndryshonte qasjen, mbase nuk do të ishte e nevojshme tarifa. Por, nëse kjo nuk ndodh, dhe Kosovës nuk i premtohet ajo që e meriton, atëherë BE-ja nuk mund ta fajësojë dikë tjetër përveç vetes", ka thënë Engel për "AlbaLife TV". "Unë nuk mendoj se administrata Trump e ka përfshi Kosovën në itinerarin e vet. Për këtë arsye, unë dua që të bisedoj me sekretarin e Shtetit, zyrtarë të tjerë, apo edhe me vetë presidentin, që t'ua them opinionin tim, si një person nga Kongresi që di shumë mirë për Kosovën, apo edhe si zyrtar i Punëve të Jashtme. Do të doja që administrata amerikane të jetë më e angazhuar në çështjen e Kosovës. Shtetet e Bashkuara kanë një rol të rëndësishme në vëzhgimin e demokracisë në Kosove se si lulëzon e rritet. Kjo është ajo që ne duhet të bëjmë. Kosovarët kanë punuar shumë dhe janë shumë pro amerikanë, andaj ne ua kemi për borxh që të kujdesimi për ta dhe të sigurohemi që populli i Kosovës të mos ngacmohet as nga Serbia as nga asnjë vend tjetër. Andaj derisa të jem aty do të sigurohem që gjërat të shkojnë siç duhet", ka thënë kongresisti amerikan, Eliot Engel.

# Kurti kërkon ndihmë nga ShBA-ja për ndaljen e çnjohjeve nga Serbia

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kërkuar nga faktorët relevantë ndërkombëtarë, në radhë të parë ShBA-ja dhe BE-ja, si ndërmjetës në procesin e dialogut, ta shtojnë trysninë mbi Serbinë që ta ndërpresë politikën armiqësore dhe destruktive ndaj Kosovës



**Prishtinë, 3 mars (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kërkuar nga faktori ndërkombëtar që t'i ndalë politikat destruktive të Serbisë kundër shtetësisë së Kosovës. Një reagim i tillë i Kurtit erdhi pasi ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Ivica Daçiq, ka thënë se edhe Siera Leone ka tërhequr njohjen e pavarësisë së Kosovës. "I bëj thirrje Serbisë zyrtare që ta ndalë këtë ofensivë dhe të heqë dorë nga politikat destruktive ndaj Kosovës dhe shtetësisë së saj. Po ashtu, do të kërkoj nga faktorët relevantë ndërkombëtarë, në radhë të parë ShBA-ja dhe BE-ja, si ndërmjetës në procesin e dialogut, ta shtojnë trysninë mbi Serbinë që ta ndërpresë politikën armiqësore ndaj Kosovës", u shpreh kryeministri Kurti.

Në një postim në llogarinë e vet në "Facebook", kryeministri Kurti ka thënë se vullnetit të tij të mirë për heqjen e pjesshme të tarifës, Qeveria serbe po i përgjigjet me shtim të fushatës së çnjohjeve së pavarësisë së Kosovës.

Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka thënë të martën se ende nuk ka informacione zyrtare lidhur me pretendimet e Serbisë se Siera Leone e ka tërhequr njohjen e pavarësisë së Kosovës. "Ne nuk kemi asnjë informacion sa i përket kësaj që ka pretenduar ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiq. Kjo për ne është e njohur, së paku si fushatë të cilën Serbia nuk e ka ndaluar asnjëherë kundër pavarësisë së shtetësisë së Kosovës", ka thënë Konjufca për mediat në Prishtinë.

Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Ivica Daçiq, ka thënë se Siera Leone e ka tërhequr njohjen e pavarësisë së Kosovës si shtet i pavarur. "Me kënaqësi të veçantë mund ta tregoj notën nga Ministria e Jashtme, në të cilën thuhet se Siera Leone e tërheq njohjen e Kosovës", ka thënë Daçiqi gjatë një vizite në këtë vend të Afrikës. Sipas Daçiqit, kjo do të thotë se Kosova nuk e ka shumicën në Kombet e Bashkuara. Sipas tij, nga 193 vende të OKB-së, 92 vende e njohin pavarësinë e Kosovës, 96 vende nuk e njohin, ndërsa pesë vende kanë qëndrim fluid, që do të thotë se e njohin Kosovën, por nuk votojnë më për të.

## Amerikanët votojnë për përzgjedhjen e kandidatit demokrat për president




**Uashington, 3 mars** - Amerikanët kanë votuar të martën në 14 shtete për përzgjedhjen e kandidatit demokrat për president.

Votimi do të përcaktojë rreth një të tretën e delegatëve të rinj në rang vend.

Pas garës në shtetet Ajova, Nju Hempshër, Nevada dhe Karolina e Jugut, e ashtuquajtura "Super e Marta" i jep një ton mbarëkombëtar procesit të nominimit. Votuesit në shtete perëndimore, jugore, verilindore dhe ata në mesin e Shteteve të Bashkuara, së bashku me territorin amerikan Samoa, dalin për të votuar në të njëjtën kohë.

Senatori i Vermontit, Bernie Sanders, udhëheq garën me 58 delegatë të fituar. Ai mund të marrë edhe më shumë mbështetje nga votuesit në Kalifornia dhe Teksas ku sondazhet tregojnë se ai është para të gjithë kandidatëve të tjerë.

Shteti i tretë më i rëndësishëm në garë është Karolina e Veriut, ku anketimet treguan se senatori Sanders dhe ish-nënpresidenti Joe Biden janë në një garë të ngushtë.

Bideni sapo fitoi në shtetin e Karolinës së Jugut dhe ka siguruar tashmë 50 delegatë. Në vendin e tretë radhitet senatorja nga Masaçusets, Elizabeth Warren, e cila pasi pësoi disa humbje, fitoi të gjithë 8 delegatët e saj në shtetin Ajova. Në shtetin e saj Masaçusets, një anketim tregon se ajo është në një garë të ngushtë me senatorin Sanders.

"Super e Marta" erdhi me ndryshime të mëdha për garën elektorale.

Senatorja e Minesotas, Amy Klobuchar, njoftoi fundin e kandidimit të saj dhe njoftoi se do ta mbështesë Bidenin. Ajo u bë kështu pjesë e një grupi të moderuar demokratësh që po shprehin mbështetjen në minutën e fundit për ish-nënpresidentin Biden.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti Hashim Thaçi është kthyer nga vizita zyrtare në ShBA

# Presidenti kërkon të raportojë në Kuvend për takimin me Vuçiqin



**Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që ta thërrasë një seancë në të cilën do t'i njoftojë deputetët për takimin e tij me presidentin serb Aleksandër Vuçiq në Shtëpinë e Bardhë. Pas këtij takimi, shefi i shtetit ka shprehur optimizëm për marrëveshjen finale Kosovë - Serbi. Kuvendi nuk ka treguar se kur do ta thërrasë këtë seancë. Ndërsa njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se taksa ndaj produkteve serbe po e zhvendos Kosovën nga agjenda e ShBA-së për rajonin**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 3 MARS - Presidenca i ka dërguar shkresë zyrtare Kuvendit të Kosovës, në të cilën ka kërkuar që presidentit Hashim Thaçi t'i organizohet një seancë më 4 mars për t'i njoftuar në lidhje me vizitën e realizuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe takimet me presidentin e Serbisë atje. Në shkresën zyrtare drejtuar Sekretarit të Kuvendit, Presidenca ka kërkuar që të bëhen të gjitha përgatitjet për mbajtjen e një seance në lidhje me këtë çështje.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën në Shtëpinë e Bardhë ka realizuar një takim me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, me ftesë të emisarit special për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell. Pas takimit presidenti Thaçi ka kërkuar unitet për dialogun Kosovë - Serbi. "Kosova është e bekuar me mbështetjen e Amerikës dhe presidentit Trump. Tani jam rrugës për në Kosovë. Pres që menjëherë, të mërkurën apo të enjten, të më mundësohet raportimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për t'i njoftuar deputetët dhe qytetarët e Kosovës për takimet në Uashington dhe më specifikisht për takimin e sotëm. Duke qëndruar të bashkuara institucionet, partitë politike dhe qytetarët, Kosova do të jetë edhe më e fortë. ShBA-ja është shpresa dhe besimi ynë. I jemi mirënjohës përjetë", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook".

Për këtë takim shefi i shtetit ka folur edhe për disa medie, ku ka thënë se në këtë takim kanë folur për domosdoshmërinë e një zgjidhjeje paqësore dhe përfundimtare mes dy vendeve. "Shpresoj se në etapat e ardhshme do të kemi orientime sa i përket substancës por, në të njëjtën kohë, edhe afateve kohore. Por, ajo që mund të them aktualisht është se ky takim ka qenë takim i vullnetit të mirë, simbolikë e dërgimit të mesazhit të paqes për Kosovën dhe Serbinë dhe për Ballkanin Perëndimor", ka thënë Thaçi.

Gjatë takimeve që presidenti Thaçi ka pasur në vizitën disaditore në ShBA i është bërë e qartë se duhet të hiqet plotësisht taksa ndaj produkteve serbe në mënyrë që t'i hapet rrugë marrëveshjes finale dhe përmbylljes së dialogut me Serbinë.

Një ditë me parë subjektet politike në Kuvend nuk kanë arritur një qëndrim të përbashkët për taksën ndaj produkteve serbe. Në këtë debat, as pozita dhe as opozita nuk kanë pasur qëndrime të bashkuara për këtë çështje, ndërsa kryeministri Albin Kurti ka prezantuar planin e tij për heqje të pjesshme të taksës, të cilin nuk e mbështet partnerja e koalicionit, LDK-ja.

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se taksa po e zhvendos Kosovën nga agjenda e ShBA-së për rajonin. "Për kohë të gjatë spektri politik i Kosovës nuk ka qenë unik sa i përket taksës. Aktualisht ai është i dezorientuar dhe i përçarë rreth kësaj teme. Kështu: Qeveria nuk është unike sa i përket taksës. Ajo nuk po mund ta arrijë një vendim unik dhe të qëndrueshëm për këtë çështje. Kjo po e dëmton punën e qeverisë aktuale dhe për më keq po e rrezikon që ajo të mbetet anash nga ritmi dhe agjenda e ShBA-së për rajonin", ka shkruar në profilin e vet në "Facebook" analisti politik Faton Abdullahu.

Ai ka vlerësuar se LDK-ja nuk është unike si parti sa i përket taksës, duke shtuar se krejt ndryshe mendon dhe e shpreh qëndrimin e tij për taksën lideri i kësaj partie, Isa Mustafa e krejt ndryshe mendon kryeparlamentarja Vjosa Osmani. "Opozita, gjithashtu, nuk është unike për taksën. Ndryshe mendon PDK-ja e krejt ndryshe AAK-ja. Kjo gjithsesi nuk është kauzë mbi të cilën opozita mund të ndërtojë strategji unike opozitare. Kjo nuk është e mirë për shëndetin demokratik të vendit tonë", ka vlerësuar ai.

### Grenelli: Nuk po nxitojmë për marrëveshjen finale Kosovë - Serbi

Vizita e gjatë e presidentit Thaçi në ShBA dhe takimi i tij me homologun serb në Shtëpinë e Bardhë ka nxitur dyshime se Kosova dhe Serbia së shpejti do ta kenë një marrëveshje finale. Mirëpo një gjë e tillë e ka mohuar i dërguari i posaçëm për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell.

Duke iu përgjigjur pretendimeve të gazetarit britanik Tim Judah, i cili në llogarinë e tij në "Twitter" ka shkruar se ShBA-ja dhe njerëzit e presidentit Donald Trump duan të lëvizin shpejt në arritjen e marrëveshjes, ambasadori Grenell ka thënë se kjo nuk është e vërtetë. "E keni gabim. Ju nuk e dini se për çfarë po flisni. Askush nuk po përpiqet t'i lëvizë gjërat shpejt dhe nuk ka asnjë marrëveshje të madhe. Ju po trilloni gjëra", ka thënë Grenell në "Twitter".

Gazetari britanik mendon se Kosova dhe Serbia janë afër marrëveshjes. "Mund të jemi afër pikës vendimtare në dialogun Kosovë - Serbi, pas takimit të djeshëm në Uashington midis Hashim Thaçit dhe Aleksandër Vuçiqit", ka shkruar Judah në "Twitter".

Ndërsa kryeministri Albin Kurti, gjatë seancës parlamentare për taksën, ka deklaruar se presidenti i Kosovës nuk ka autorizim të nënshkruajë marrëveshje me Serbinë. "Presidenti aktual nuk ka autorizim për të nënshkruar marrëveshje me Serbinë dhe nuk ka fuqi implementuese për çfarëdo marrëveshje që mund ta imagjinojë ai. Kjo nuk do të ndodhë. E di që ka pasur një plan që është më shumë se ide që të bëhet heqja e tarifës dhe të nesërmen të përfundojë dialogu me një marrëveshje", ka thënë Kurti.




Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka propozuar tërheqjen nga misionet diplomatike të gjashtë ambasadorëve

# NË MESIN E PROPOZIMEVE PËR TËRHEQJE, EDHE AMBASADORJA MË DINJITOZE QË KA PASUR KOSOVA

Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka propozuar tërheqjen nga misionet diplomatike të gjashtë ambasadorëve dhe një konsulli. Personat e propozuar për tërheqje nga misionet diplomatike janë: Vlora Çitaku (Uashington), Edon Cana (Sofje), Lirim Grejçevci (Hagë), Shpend Kallaba (Budapest), Mimoza Ahmetaj (Strasburg), Ylber Hysa (Podgoricë) dhe Ramadan Avdiu (konsull në Gjenevë). Ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, ka thënë se do ta respektojë kërkesën e Qeverisë së Kosovës. "Mua më mjafton fakti tashmë i ditur botërisht, se unë jam e padëshiruar. Megjithatë, besoj se e kam merituar një konsultim paraprak lidhur me propozimin në fjalë. Nuk ka ambasador të përjetshëm. E përjetshme është vetëm Kosova dhe shërbimi për të", ka thënë Çitaku pas marrjes së lajmit për tërheqje nga misioni diplomatik

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 3 mars** - Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka propozuar tërheqjen nga misionet diplomatike të gjashtë ambasadorëve dhe një konsulli. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se personat e propozuar për tërheqje nga misionet diplomatike janë: Vlora Çitaku (Uashington), Edon Cana (Sofje), Lirim Grejçevci (Hagë), Shpend Kallaba (Budapest), Mimoza Ahmetaj (Strasburg), Ylber Hysa (Podgoricë) dhe Ramadan Avdiu (konsull në Gjenevë). "Që në fillim të mandatit jam zotuar për vendosjen e rregullit dhe ligjit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Një ndër hapat e radhës është edhe kërkesa për kthimin e ambasadorëve politikë që e kanë përfunduar mandatin katërvjeçar të paraparë sipas ligjeve në fuqi të Republikës se Kosovës. Duke u bazuar në nenin 93, pika 8 dhe nenin 84, pika 25 e Kushtetutës së



Republikës së Kosovës, si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës (GZ. Nr 46/15 janar 2009) dhe bazuar në nenin 10 (paragrafi 9) të Rregullores për Shërbimin e Jashtëm dhe me qëllim të respektimit të nenit 7,7 të Ligjit Nr. 03/L-207 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, (GZ.76, 10 gusht 2010), në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës propozoj tërheqjen nga misioni të këtyre ambasadorëve politikë", ka shkruar Konjufca.

Më 20 shkurt ministri Konjufca ka shkarkuar 14 persona që ishin angazhuar si konsuj nëpër ambasada e konsullata të ndryshme të Kosovës në botë.

Pas kërkesës së ministrit Konjufca, ka reaguar Presidenca e Kosovës.

Përmes një deklarate dërguar mediave, thuhet se deri më tani kjo zyrë nuk ka pranuar zyrtarisht asnjë propozim për tërheqje ambasadorësh. "Por, emërimi dhe shkarkimi i ambasadorëve është e drejtë ekskluzive kushtetuese e Presidentit të Republikës së Kosovës. Nëse këto propozime vijnë zyrtarisht nga ana e Qeverisë, presidenti gjithsesi që i shqyrton", thuhet në deklaratën e Zyrës së Presidentit.

Ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se do ta respektojë kërkesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me gjithë faktin se vetëm presidenti i Kosovës ka të drejtë t'i emërojë dhe shkarkojë ambasadorët e Republikës së Kosovës. "Sigurisht, unë do ta respektoj kërkesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndonëse e kam të qartë se ligjërisht vetëm presidenti i Kosovës ka të drejtë t'i emërojë dhe shkarkojë ambasadorët e Republikës së Kosovës, mua më mjafton fakti tashmë i ditur botërisht, se unë jam e padëshiruar. Megjithatë, besoj se e kam merituar një konsultim paraprak lidhur me propozimin në fjalë", ka shkruar Çitaku.

Ajo ka thënë se si ambasadore është emëruar përmes çelësit politik. "Këtë e kam thënë shumë herë më parë, dhe është krejt e natyrshme që Qeveria e Kosovës ta kërkojë zëvendësimin tim. Mirëpo, unë nuk do të lejoj që të bëhem mish për top në betejën mes Qeverisë dhe Presidencës. Në këtë periudhë transitore do të mundohem t'i përmbush të gjitha detyrat me përgjegjësi ashtu siç kam bërë çdoherë. Shpresoj që institucionet e Republikës së Kosovës të pajtohen shpejt për pasuesen/pasuesin tim", ka thënë ambasadorja Çitaku.

Ajo ka shtuar se ambasadores/ambasadorit që do të vijë pas saj do t'i ofrojë bashkëpunim të plotë dhe të pakursyer. "Kam pasur nderin dhe privilegjin e veçantë që me nder dhe përgjegjësi t'u shërbej tre kryeministrave dhe dy presidentëve. Në ShBA e kam përfaqësuar Kosovën siç kam ditur më së miri. Frymëzimi im gjithmonë kanë qenë dhe do të mbeten qytetarët e Kosovës, të cilët i kam përfaqësuar në Uashington. Mesazhi im në kryeqytetin amerikan ka qenë pikërisht jehona e historive të tyre të rimëkëmbjes. Nuk ka ambasador të përjetshëm. E përjetshme është vetëm Kosova dhe shërbimi për të", ka përfunduar shkrimin e saj, ambasadorja Vlora Çitaku.

Këshilltari i presidentit Hashim Thaçi, Artan Behrami, përmes një reagimi në profilin e vet në "Facebook" ka thënë se atë që dështoi ta bëjë për shumë vite ministri serb, Ivica Daçiq, po e bën sot Glauk Konjufca. "Atë që dështoi ta bëjë ministri serb, Ivica Daçiq, tash e shumë vite në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e bëri sot ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Glauk Konjufca, përmes një tentimi për ta larguar ambasadoren më të mirë që ka Republika jonë. Ambasadorja Vlora Çitaku për një kohë të gjatë ka fituar çdo betejë kundër ministrit serb, Daçiq, i cili, më shumë se kushdo tjetër në botë, kërkon zëvendësimin e saj", ka thënë Behrami.

Ai ka theksuar se politika e Jashtme e Kosovës duhet të orientohet në koordinimin e veprimeve me partnerët strategjikë të Kosovës për ta forcuar subjektivitetin ndërkombëtar dhe për ta përmbyllur anëtarësimin e Kosovës në sistemin ndërkombëtar.

## Çfarë thotë Kushtetuta dhe ligji

Në bazë të nenit 93 të Kushtetutës së Kosovës, qeveria i "propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shefa të misioneve diplomatike të Kosovës". Ndërkaq, në paragrafin e 25 të nenit 84 të Kushtetutës, presidenti i vendit "emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë". Mirëpo, në këtë rast ministri Konjufca është thirrur edhe në Ligjin për ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës.

Në nenin 7, paragrafin 7.8 të këtij ligji, thuhet "të emëruarit në pozitën e Ambasadorit dhe Shefit të Misionit që nuk janë angazhuar në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës shërbejnë vetëm për një mandat, dhe pas përfundimit të këtij mandati, nuk konsiderohen pjesë e Shërbimit të Jashtëm".




# MINISTRI REKA: INTEGRIMI EVROPIAN ËSHTË DETYRË E TË GJITHËVE

**Prishtinë, 3 mars (ER)** - Ministri i Integrimit Evropian, Blerim Reka, për herë të parë të martën ka raportuar në Komisionin Parlamentar për Integrim Evropian. Në ekspozenë e tij, ministri Reka paraqiti të gjeturat në ministrinë që udhëheq, raportoi mbi realizimin e prioriteteve në integrimin evropian si dhe për prioritetet e kësaj ministrie në këtë proces. Po ashtu, theksoi se mbetet shumë punë për t'u bërë sepse as gjysma e MSA-së nuk është zbatuar, sikur as ERA 1, si dhe mospërmbyllja e IPA 2.

Në këtë drejtim Reka ka theksuar edhe procesin e liberalizimit të vizave ku potencoi edhe një herë çështjen e 61 rasteve të shënjestruara të profilit të lartë të krimit të organizuar dhe të korrupsionit ku nuk janë dorëzuar prova për përfundimin e tyre gjyqësore, gjë e cila po kërkohet prej shteteve hezituese në vendimmarrjen e tyre pozitive të liberalizimit të vizave.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ministri Reka ka potencuar se procesi i integrimit evropian është stafetë maratone, nuk është çështje e një qeverie, por është çështje e tërë shoqërisë dhe tërë shtetit. Ai ka kërkuar që së paku këtu pozita dhe opozita të kenë një bashkim rreth këtij përcaktimi strategjik për vendin tonë.

Ministri Reka ka ritheksuar se gjatë mandatit të tij do të udhëhiqet nga parimi i llogaridhënies dhe transparencës.

Ndërkaq kryetari i Komisionit për Integrime Evropiane, Armend Zemaj, pasi e uroi ministrin Reka për detyrën në kabinetin qeveritar dhe suksese në punët që e presin, e siguroi atë për një bashkëpunim të ngushtë dhe të sinqertë për përmbushjen e objektivave të Ministrisë.

Zemaj vuri në dukje aspekte nga fushëveprimtaria e komisionit, e që ndërlidhen me Ministrinë e Integrimeve. "Mbikëqyrja e zbatimit të MSA-së dhe ERA-s janë vetëm disa nga angazhimet e komisionit", tha ai.

Më tutje, kryetari i komisionit foli edhe për çështjet për të cilat komisioni do të jetë i angazhuar, e që janë: mbikëqyrja e punës së ekzekutivit, shqyrtimi i procesit të harmonizimit dhe përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së, si dhe diplomacia parlamentare.



Reagim i KMDLNj-së

# Degradimi i gjuhës parlamentare në Kuvendin e Kosovës!

Më datë 02.03.2020 është mbajtur seanca e jashtëzakonshme e thirrur nga partitë opozitare lidhur me paralajmërimin e kryeministrit Kurti për heqjen e taksës 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Sipas paralajmërimit të kryeministrit të Kosovës, taksa 100 për qind do të hiqet sipas një dinamike kohore, do të jetë e kushtëzuar dhe varësisht nga sjelljet e Serbisë kjo taksë do të zëvendësohet me masën e reciprocitetit. Paralelisht me seancën e jashtëzakonshme, para ndërtesës të rinjtë e AAK-së e bënë një performancë simbolike duke e lënë një arkivol mbi të cilin ishin vendosur parimet dhe premtimet që, sipas të rinjve të AAK-së, i kishte shkelur kryeministri Kurti.
Arkivoli i vendosur në shesh dhe i stolisur me slogane ishte kopje e protestave masive të shqiptarëve para luftës në Kosovë që e varrosnin dhunën duke bartur një arkivol. Gjatë këtij kundërshtimi që i bënë të rinjtë e AAK-së heqjes së taksës 100 për qind. Policia e Kosovës arrestoi disa aktivistë të AAK-së të cilët nuk ishin të dhunshëm, por protestuan në mënyrë paqësore për t'u liruar pasi u morën në pyetje nga Policia e Kosovës. Arrestimin e të rinjve protestues të AAK-së, KMDLNj e konsideron krejtësisht të paarsyeshëm, të panevojshëm dhe në kundërshtim të të drejtave të njeriut për lirinë e shprehjes dhe tubimit të lirë e që është e rregulluar me ligjet në fuqi. Se çfarë porosie bartë vendosja e arkivolit është çështje që interpretohet sipas interesave politike dhe të tjera.
Gjatë seancës së jashtëzakonshme shumica e diskutimeve ishin në përputhje me gjuhën parlamentare, përjashtuar disa raste që kanë eskaluar dhe për të cilat kryetarja e Kuvendit, znj. Osmani, është dashur të reagojë menjëherë, duke ua ndërprerë fjalën.



Deputeti Shkumbin Demalijaj duhet t'i kërkojë falje publike kryeministrit të Kosovës, z. Albin Kurti, për cilësimet e bëra në këtë seancë të jashtëzakonshme sikur që deputeti i LV-së, Dimal Basha, duhet t'u kërkojë falje publike anëtarëve të Bordit të shkarkuar të "Infrakos"it për cilësimet fyese dhe denigruese.
KMDLNj ua përkujton të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, se kanë përgjegjësi për fjalën publike dhe nuk gëzojnë asnjë imunitet nga cilësimet raciste, denigruese, poshtëruese dhe të qëllimshme për ta komprometuar personalitetin e kundërshtarit politik.
Duhet të përkufizohet qartë e drejta për debat parlamentar nga përgjegjësitë që u takojnë institucioneve të tjera si janë Policia e Kosovës, prokuroria dhe gjykatat.
Në këtë kontekst, KMDLNj u sugjeron të gjithë atyre që edhe në sallën e Kuvendit fyhen dhe akuzohen pa asnjë bazë, të kërkojnë shpagim nga organet e drejtësisë në mënyrë që të vendoset një kulturë e komunikimit mbështetur në vlerat e një parlamentarizmi të mirëfilltë.
KMDLNj kërkon nga kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani, që të jetë shumë e prerë në raste kur nëpërkëmbet dinjiteti i çdo deputeti apo familjarëve të tyre duke i ndërprerë fjalën.
Do të duhej që me autoritetin që ia njeh ligji, kryetarja e Kuvendit dhe Kryesia e Kuvendit ta sanksionojnë fjalorin degradues, duke i larguar nga seanca deputetët që bëjnë cilësime degraduese, për një afat të caktuar.
Në rast kur fjalori degradues, akuzues, fyes dhe kërcënues përmban elemente të natyrës personale, Prokuroria duhet të reagojë sipas autorizimeve dhe detyrës zyrtare.
KMDLNj kërkon nga deputetët e Kuvendit të Kosovës ta respektojnë Kodin minimal të sjelljes parlamentare, që opozita dhe pozita të kontribuojnë për shtensionimin e situatës, ta përfaqësojnë dhe mbrojnë interesin e qytetarëve të Kosovës, pa dallim përkatësie partiake apo politike.
Deputetët janë deputetë të të gjithë qytetarëve të Kosovës, prandaj duhet të sillen si të tillë.

# Rahoveci, Mitrovica dhe Prishtina, komunat më transparente për vitin 2019

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 3 mars** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe organizata joqeveritare "Aktiv" kanë publikuar të martën "Indeksin e Transparencës" për 38 komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Vlerësimi është bërë në gjithsej 48 indikatorë, të cilët e kanë burimin në legjislacionin vendor dhe në praktikat më të mira të transparencës dhe llogaridhënies publike. Komuna më transparente për vitin 2019 është vlerësuar ajo e Rahovecit me gjithsej 85 pikë nga 96 sa janë maksimale, ndërsa komuna më së paku



transparente është vlerësuar komuna e Mitrovicës Veriore me 39 pikë. Dhjetë komunat me nivelin më të kënaqshëm të transparencës janë: Rahoveci (85 pikë), Mitrovica e Jugut e Prishtina (83 pikë), Drenasi, Vitia dhe Malisheva (80 pikë), Suhareka, Gjakova, Peja dhe Vushtrria (78 pikë). Pesë komunat me nivelin më të ulët të transparencës janë: Deçani (50 pikë), Zubin Potoku (46 pikë), Fushë Kosova (45 pikë), Juniku (44 pikë) dhe Mitrovica e Veriut (39 pikë). Me këtë rast, drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka thënë se, përveç matjes së transparencës në 38 komuna sikurse edhe në vitet e mëparshme, kjo organizatë ka punuar aktivisht në 11 komuna, duke organizuar dhe ndërmjetësuar më shumë se 240 takime me komunitetin dhe përfaqësuesit e autoriteteve komunale për të gjetur zgjidhje për problemet dhe prioritetet lokale. Ndërsa Caleb Waugh nga organizata joqeveritare "Aktiv" ka theksuar se është me rëndësi të nënvizohet roli i organizatave joqeveritare në monitorimin e institucioneve dhe ushtrimin e presionit pozitiv për të garantuar transparencë dhe qeverisje të mirë". Në anën tjetër, ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott, ka thënë se transparenca është vlerë thelbësore e demokracisë. "Një udhëheqës me integritet do të duhej t'u tregojë qytetarëve të vet se si po shpenzohen taksat e tyre dhe se a po mbahen premtimet e bëra në fushatë zgjedhore", ka thënë Abbotti. Më tutje, ministrja e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Emilia Rexhepi, ka thënë se transparenca është detyrim kushtetues e ligjor i organeve të pushtetit si në nivel lokal, po ashtu edhe në atë qendror.

# Shërbimi Korrektues i pezullon lejen e punës një të burgosuri

**Prishtinë, 3 mars (ER)** - Shërbimin Korrektues i Kosovës të martën ka pezulluar lejen e punës jashtë institucionit korrektues për të burgosurin A. H., pasi i njëjti nuk ka qenë i pranishëm në vendin e punës.
Gjatë vizitës së zyrtarëve korrektues nëpër lokacionet e vendeve të punës, në njërin nga lokacionet ka rezultuar se i dënuari A. H. nuk ka qenë në vendin e punës sipas marrëveshjes andaj, në bazë të kompetencave që ka Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka marrë vendim që të njëjtit t'i pezullohet leja e punës jashtë institucionit.
ShKK-ja që nga muaji nëntor i vitit të kaluar ka filluar zbatimin e Udhëzimit Administrativ në Qendrën Korrektuese të tipit të hapur të Smrekonicës për punën e të burgosurve jashtë institucionit korrektues, me ç'rast deri më tani nga ky vendim kanë përfituar katërmbëdhjetë të dënuar.
Puna e të burgosurve jashtë institucionit korrektues është një aktivitet i nevojshëm drejt risocializimit të suksesshëm dhe përgatitjes së tyre për t'u rikthyer në shoqëri si individë të përgjegjshëm dhe të dobishëm për shoqërinë. Me këtë Udhëzim Administrativ, ShKK-ja synon realizimin e misionit të saj ligjor për parandalimin e përsëritjes së krimit në të ardhmen, duke synuar një shoqëri ku sundon rendi dhe ligji, andaj keqpërdorimet e tilla janë të papranueshme dhe asnjëherë nuk do të jetë tolerante ndaj veprimeve të tilla.



# Në Kosovë u testuan 42 raste me koronavirus, por rezultatet dolën negative

Sëmundja vdekjeprurëse e koronavirusit tashmë ka prekur mijëra njerëz nga rreth 56 shtete të botës, megjithatë Kosova vazhdon ende të jetë e paprekur nga ky virus. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se për një muaj në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare janë testuar gjithsej 42 mostra të dyshimta me koronavirus, por që të gjitha kanë rezultuar negative. Ekipe të infektologëve po qëndrojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" dhe në pikat kufitare ku po kontrollohen udhëtarët që vijnë nga shtetet që janë të prekur nga koronavirusi




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MARS - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se nga data 8 shkurt deri më 3 mars në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën "RT-PCR" janë testuar gjithsej 42 mostra të dyshimta me virusin SARS-CoV-2, i njohur si koronavirus, dhe të gjitha kanë rezultuar negative. "Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) gjatë ditës së sotme, më 3 mars 2020, ka marrë informatë nga Klinika Infektive e QKUK-së për gjashtë raste të dyshimta në COVID-19. Pacientët u kontrolluan nga ekipi i infektologëve në Klinikën Infektive në QKUK dhe iu morën mostrat për testim laboratorik në virusin SARS-CoV-2. Me datë 03.03.2020 në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK janë testuar gjashtë pacientë në virusin SARS CoV-2 dhe kanë rezultuar negative, prej të cilave dy të ritestuara negative në virusin SARS CoV-2 dhe një pozitive në Influencën A", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Sipas këtij njoftimi, nga data 01.02.2020 deri më 03.03.2020 nga aeroporti ndërkombëtar "Adem Jashari" si dhe pikat tokësore kufitare janë depistuar gjithsej 1 879 udhëtarë. "Nga Aeroporti 'Adem Jashari' 327 udhëtarë, Merdare 779, Vërmicë 599, Jarinje 85, Dheu i Bardhë 40, Hani i Elezit 29, Kullë 7, Qafë Morinë 7 dhe Bërnjak 6, udhëtarë", është theksuar në njoftimin e IKShPK-së.

Të martën në Kolegjin UBT është mbajtur tryeza e diskutimit me temën "A jemi të përgatitur për koronavirus".

Hapjen e diskutimit e ka bërë rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, i cili ka theksuar se debati është organizuar me qëllim për të reflektuar si institucion, por edhe për ta treguar gatishmërinë e UBT-së për dhënien e ekspertizave profesionale akademike në këtë drejtim. Rektori Hajrizi tha se duhet të ekzistojë një sistem mirë i dizajnuar ku përfshihen të gjitha palët, në mënyrë që të menaxhohen situata të tilla.

Profesori në UBT, Dukagjin Sokoli, ka thënë se situata e krijuar nga ky virus ka shkaktuar panik te qytetarët e Kosovës mirëpo, sipas tij, kjo situatë mund të menaxhohet nëse qytetarët iu përmbahen rekomandimeve të dhëna. "Virusi është përhapur dhe është shumë infektiv. Qytetarët janë të shqetësuar, prandaj është organizuar kjo tryezë për parandalimin e frikës dhe panikut", ka thënë ai.

Naser Ramadani nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ka treguar se në vendin tonë nuk ka asnjë rast të prekur nga ky virus. Ai ka theksuar se ekipe të infektologëve po qëndrojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" si dhe në pikat tokësore kufitare, ku po kontrollohen udhëtarët që vijnë nga shtetet që janë të prekur nga koronavirusi. "30 janari është shpallur emergjencë e shëndetësisë publike dhe me këtë rast instituti ka ngritur edhe gjendjen e gatishmërisë. Kosova është vend i rrethuar nga shtetet që kanë shënuar raste pozitive nga ky virus, por nuk ka vend për panik, por për kujdes të shtuar duke përfillur të gjitha rekomandimet e dhëna për mbrojtje", ka treguar ai.

Ndërkaq specialistja e Ekonologjisë, Drita Zogaj, ka shprehur shqetësimin që Klinika Infektive ka mungesë të stafit që është i specializuar në fushën e këtyre viruseve. "Të gjitha pikat që kërkohen nga OBSh-ja i kemi zbatuar, duke filluar nga sensibilizimi i opinionit, duke i treguar për masat mbrojtëse. Ka plan të veprimit ani pse laboratorët mjekësorë nuk janë të akredituar sepse udhëzimet administrative kërkojnë një gjë të tillë. Tashmë kemi edhe mungesë të stafit që është i specializuar në këtë drejtim", ka thënë ajo.

Më tutje, pulmologu Xhevat Kurhasani konsideron se Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike duhen të krijojnë partneritet me institucione relevante për veprim dhe sensibilizim të opinionit në këtë drejtim. Ai ka treguar se tashmë janë komercializuar maskat, si dhe vërehet dukshëm shtrenjtimi i maskave mbrojtëse. "Sëmundjet ngjitëse janë sfidë në botë, megjithatë në Kosovë këto ditë shqetësues ka qenë edhe gripi sezonal, ku qindra nxënës kanë munguar në shkolla shkaku i këtij gripi sezonal. Sa i përket koronavirusit, ajo çka paraqitet në media mendoj se nuk përkon me realitetin në shumicën e rasteve. Ka shtrenjtim të dezinfektuesve dhe janë komercializuar maskat", ka thënë ai.

Specialistja e Mikrobiologjisë, Rukije Meka-Kastrati, ka potencuar se vdekshmëria nga koronavirusi ka qenë në numër më të vogël sesa i çdo virusi tjetër si virusi SARS ose MERS.

Javën e kaluar është konfirmuar edhe rasti i parë me koronavirus në Maqedoni, teksa Kosova dhe Shqipëria vazhdojnë të jenë të paprekura nga ky virus.

Në Kosovë u testuan mbi 42 raste me këtë virus, mirëpo të gjitha rezultuan negative. Ndërkohë, në nivel global, sipas raportit të fundit nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, janë raportuar mbi 82 mijë raste me koronavirus, derisa në BE dhe Mbretëri të Bashkuar janë raportuar 477 raste me këtë virus dhe 14 raste të vdekjes, në Itali 12 raste, si dhe Francë dy raste.

## Franca shpreh gatishmërinë për ta përkrahur Kosovën në fushën e arsimit



PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka pritur të martën në takim ambasadoren e Francës në Kosovë, Marie Christine Butel, me të cilën ka biseduar për gjendjen në arsim dhe për programin qeveritar për ta përmirësuar sistemin arsimor në të gjitha nivelet.

Ambasadorja Butel e ka uruar ministren Bajrami për detyrën e re dhe ka shprehur gatishmërinë për ta mbështetur në prioritetet dhe planet për zhvillimin e arsimit në Kosovë. Ministrja Bajrami e ka falënderuar ambasadoren Butel për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë Franca për Kosovën në faza të ndryshme, ndërsa ka theksuar se mbështetja në arsim është e një rëndësie të veçantë. Ajo e ka informua ambasadoren Butel edhe me vështirësitë dhe sfidat që po ballafaqohet arsimi në të gjitha nivelet, por ka theksuar se me bashkëpunim mes të gjithë aktorëve dhe me mbështetjen e partnerëve zhvillimorë, mund të arrihet synimi për ofrimin e një arsimi cilësor për fëmijët dhe të rinjtë tanë.

# Kurti: Duhet t'i ndihmojmë ndërmarrësit që të rriten punësimi, prodhimi dhe zhvillimi

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 MARS - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë të martën në punëtorinë e organizuar nga Oda e Afarizmit të Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Kurti para të pranishmëve të shumtë tha se na pret shumë punë që duhet ta bëjmë bashkë me juve sepse zhvillimi ekonomik është prioritet. "Gjithsesi, nuk është rastësi që po flasim kaq shumë kohëve të fundit për barrierat tregtare dhe për ekonominë sepse këto do të jenë temat e qeverisë sonë: ekonomia dhe drejtësia, puna dhe mirëqenia. Temat e tjera do të marrin vëmendjen e duhur, por asnjëherë të gjithë vëmendjen", ka thënë kryeministri Kurti.

Më tej, Kurti ka theksuar se duhet ta ndihmojmë biznesin vendës, ndërmarrësit, në mënyrën që të rritet punësimi, të rriten kompanitë, të rritet prodhimi, të rritet zhvillimi e të rritet edhe paga mesatare në sektorin privat. "Është absurde që paga mesatare në sektorin publik është mbi 500 euro, me një rritje mbi 100 euro në pesë vjetët e fundit, ndërkohë që kjo rritje nuk është as 15 euro në sektorin privat, ku ju e dini që pagat mesatare ngelen rreth 350 euro", tha kryeministri Kurti, duke shtuar se ata të cilët duan të punojnë më shumë, duan të fitojnë më shumë, duhet ta kenë mundësinë te sektori privat dhe garancinë e shtetit për sundim të ligjit e për konkurrencë fer.

Kurti ka theksuar se Kosova është vend sovran dhe i pavarur por, sipas tij, sovraniteti dhe pavarësia e saj kanë kuptim vetëm kur i ushtrojmë ato dhe vetëm kur kemi një popullsi që i gëzon ato. "Gëzimi i pavarësisë dhe sovranitetit kalon nëpër zhvillimin ekonomik që sjell punësim e mirëqenie", është shprehur Kurti.

Kryeministri ka folur edhe për bashkëpunimin me Shqipërinë. "Natyrisht, me Shqipërinë do të donim që të kemi sa më shumë ndërveprim e bashkërendim, në mënyrë që dallimet tona në ekonomi e në politikë të jenë edhe më të vogla sesa dallimet ndërmjet dialekteve të gjuhës tonë nëpër krahinat e kombit tonë. Fatkeqësisht, realiteti është ndryshe", ka thënë ai.




Kurti ka shtuar se barrierat me Shqipërinë tejkalojnë dallimet tona në dialekt dhe janë të tilla që i dëmtojnë prodhuesit dhe eksportuesit. "Për të kaluar në tokën shqiptare transportuesit obligohen që për çdo kamion që sjell mallra në Kosovë nga vendet e BE-së përgjatë transitit në Shqipëri ta paguajnë taksën e skanimit prej 22 eurosh e këtë taksë e paguajnë edhe në ato raste kur nuk funksionon skaneri, që tregon se nuk janë në pyetje çështjet funksionale të sigurisë, por të gjobitjes për llogari të dikujt", ka deklaruar Kurti.

Po ashtu, Kurti ka thënë se me Maqedoninë e Veriut po ashtu ka pengesa që duhen hequr. "Procedura të zgjatura të zhdoganimit, kërkesa për certifikata shtesë dhe teste shtesë e të panevojshme vendosen për ta vështirësuar e dekurajuar punën e bizneseve tona dhe eksportet tona. Kosova ka një bilanc negativ tregtar me të gjitha vendet e CEFTA-s. Eksporti ynë mbulon importin me vetëm 11 për qind, e kur këtu shtohen edhe pengesat tregtare, atëherë kërkohet ndërhyrja e shtetit për të garantuar që bizneset tona nuk u nënshtrohen standardeve të dyfishta dhe garës jolojale. Në fund të fundit, kjo është një nga arsyet se përse ekziston shteti dhe se përse ne kemi folur që herët për shtetndërtim. Garë e barabartë, konkurrencë lojale. Prandaj reciprociteti do të ndodhë, jo pse ne kemi vendosur të sillemi ndryshe, por pse ne kemi vendosur të sillemi si shtet, si shtet i pavarur, ashtu siç jemi shpallur, ashtu siç jemi", ka deklaruar Kurti.

# ATK-ja vetëm për dy muaj mblodhi rreth 98 milionë euro

PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Vetëm për dy muajt e parë të këtij viti, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka arritur që të grumbullojë 97.8 milionë euro, vlerë kjo që, nëse e krahasohet me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, janë mbledhur 9.4 milionë euro më shumë apo 11 për qind më shumë. Ndërsa në raport me planin janë mbledhur 2.7 milionë euro më shumë. "Niveli i lartë i inkasimit të të hyrave është padyshim përkushtim i plotë i menaxhmentit të lartë dhe stafit të ATK-së për ofrimin e lehtësirave në vazhdimësi për përmbushje vullnetare të



obligimeve tatimore, me theks të veçantë është duke vazhduar me ritëm të lartë trajtimi i stokut të borxheve si dhe luftimi i ekonomisë joformale - konkretisht trajtimi sipas sektorëve, ku aktualisht ATK-ja është duke trajtuar sektorin e ndërtimtarisë, i cili është vlerësuar si sektori me riskun më të lartë për evazion fiskal. Sigurisht, këto nuk janë objektivat e vetme mbi të cilat është fokusuar ATK-ja, krahas këtyre janë duke u implementuar standardet më të mira të punës, të cilat kanë reflektuar edhe në rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies nga ana e stafit të ATK-së", është thënë në njoftimin e ATK-së.

## Rinia, kapital njerëzor që mund dhe duhet të kthehet në kapital ekonomik

PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjese të martën në Kuvendin e XII të anëtarëve të Shoqatës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës - STIKK. Para të pranishmëve, kryeministri Kurti ka thënë se teknologjia na lidhë dhe na ofron mes vete dhe krijon mundësi aty ku nuk ishin më parë. "Ky potencial për zhvillim nuk bën dhe nuk duhet të injorohet, por të shfrytëzohet sepse vendet e punës kanë lëvizur dhe vetë ekonomia ka lëvizur. Jetojmë në epokën kur koha po dominon mbi vendin, ku shpejtësia po ia kalon hapësirës. E është mëkat që kanë kaluar 20 vjet pa investimet e duhura dhe pa vëmendjen e duhur të shtetit për të krijuar këtë kapital njerëzor", ka deklaruar kryeministri Kurti, duke shtuar se rinia jonë ka shkathtësitë teknologjike për të bërë analiza komplekse të të dhënave dhe për të zhvilluar uebsajte, por mungojnë investimet e duhura të cilat e lidhin tregun e punës me edukimin e rinisë. "Rinia është kapital njerëzor që mund dhe duhet të kthehet në kapital ekonomik", ka deklaruar kryeministri Kurti.



# Auditori i Përgjithshëm thotë se ishte sfidë auditimi i Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 3 mars** - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka bërë të martën prezantimin publik të raportit të performancës "Zbatimi i rekomandimeve të raportit 'Fondi Zhvillimor' dhe efektet e fondit", ku morën pjesë përfaqësues nga Dogana e Kosovës, Ministria e Financave dhe Transfereve, Komuna e Mitrovicës së Veriut, Komuna e Zveçanit si dhe përfaqësues nga shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe mediat. Me këtë rast, Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, ka thënë se kërkesa për auditimin e Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit (FZhM) ka ardhur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. "Auditimi i këtij fondi dhe vetë fondi është shumë specifik. E dini që buron nga marrëveshja e Brukselit. Ka qenë sfidë auditimi i tij, duke i marrë parasysh karakteristikat e veçanta që i atribuohen këtij fondi. Projekti, si i tillë, për ne ka qenë i rëndësishëm edhe për një fakt tjetër, meqenëse është pjesë integrale e buxhetit të shtetit dhe ne duhet të kemi informacion të bollshëm se si po menaxhohet fondi", u shpreh Osmani.

Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, vlerësoi përkushtimin e institucioneve përgjegjëse për t'i bërë përmirësimet e nevojshme në mënyrë që mjetet e FZhM-së të shpenzohen në mënyrë efektive dhe në dobi të qytetarëve të komunave në veri të Kosovës. "Kemi parë një përkushtim të institucioneve të përfshira për të bërë përmirësime. Ky është një mesazh që ish dashur t'i ndjekë të gjitha institucionet e tjera që ne auditojmë. Prandaj u bëj thirrje të gjithë aktorëve që t'i marrin me seriozitet rekomandimet e dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit, sepse ato kanë qëllim të përbashkët që ky buxhet të përdoret për të mira materiale për qytetarët e komunave në veri", ka theksuar Osmani.

Ndërsa ndihmësauditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, duke prezantuar konkluzionet kryesore të këtij auditimi, ka pohuar se komunat në veri nuk ishin mjaft efikase në vënien në dispozicion të projekteve të financuara nga Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit. "Konkluzionet kryesore të auditimit përcjellës janë se vetëm 4 nga 13 rekomandimet e dhëna janë zbatuar plotësisht, 5 rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe 4 rekomandime nuk janë zbatuar në tërësi. Prandaj në këtë aspekt progresi është i limituar dhe mbetet hapësirë për menaxhim më të mirë dhe kontroll financiar gjatë zbatimit të projekteve të financuara nga ky fond", është shprehur Spanca, duke shtuar se qytetarët janë ftuar në dëgjime, mirëpo jo për projektet e financuara nga FZhM-ja. Sipas saj, disa projekte nuk janë përfunduar brenda afateve të përcaktuara, ndërsa ka pasur projekte që ende nuk kanë filluar të zbatohen përkundër faktit se komunat kanë pasur buxhet në dispozicion.

Ndërkohë udhëheqësja e Departamentit të Auditimit, Fatlinda Ramosaj, ka thënë se auditimi ka përfshirë institucionet përgjegjëse: Bordin menaxhues të Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit, Ministrinë e Financave, Doganën e Kosovës dhe katër komunat përfituese: Mitrovicën e Veriut, Leposaviqin, Zveçanin dhe Zubin Potokun.

Ramosaj ka treguar se ky auditim ka mbuluar projektet e zhvilluara gjatë viteve 2017-2019 dhe për qëllim ka pasur vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve dhe realizimin e projekteve në të mirë të qytetarëve. "Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 13 rekomandime, 4 për Bordin e Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit, 3 për Ministrinë e Financave, 1 rekomandim për Doganën e Kosovës dhe 5 rekomandime për komunat në veri. Objektivë tjetër e këtij auditimi ka qenë efekti i këtij fondi, pra se sa projektet e financuara nga ky fond janë realizuar dhe janë venë në dispozicion të qytetarëve", ka bërë me dije Ramosaj, duke shtuar se janë tri rekomandime të reja për komunat veriore dhe dy rekomandime për Bordin menaxhues të FZhM-së.

Më tutje, udhëheqësi i ekipit, Arben Selimi dhe anëtari i ekipit, Armin Bushati, prezantuan në detaje gjetjet e raportit të performancës "Zbatimi i rekomandimeve të raportit 'Fondi Zhvillimor' dhe efektet e fondit".

Ndërkaq përfaqësuesit e komunave në veri të vendit, përkatësisht ata të Mitrovicës së Veriut dhe të Komunës së Zveçanit, u zotuan se do t'i marrin parasysh vërejtjet dhe rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës në mënyrë që mjetet e fondit të përdoren për projekte në dobi të qytetarëve të komunave veriore.

Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit është themeluar në vitin 2013 me marrëveshjen në mes të Bashkimit Evropian (BE) dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Fondi ka për qëllim ta promovojë zhvillimin social dhe ekonomik në komunat Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.




## Ministri Bislimi priti në takim përfaqësues të Bankës Botërore për dialogun makro-fiskal të Kosovës

**Prishtinë, 3 mars (ER)** - Ministri i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, ka pritur të martën në takim një delegacion të Misionit të Bankës Botërore për dialogun makro-fiskal të Kosovës, i kryesuar nga drejtori i Bankës Botërore në Kosovë, Marco Mantovanelli, ku është diskutuar për memorandumin ekonomik të vendit dhe kornizën e politikave zhvillimore. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për vazhdimin e bisedimeve me qeverinë për masat për zbatimin e këtyre politikave zhvillimore si dhe për identifikimin e nevojave për mbështetje teknike nga Banka Botërore.



# GRENELLI AGRESIV, THAÇI POSESIV, VUÇIQI FITUES DHE ALBIN KURTI SFIDUES!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Po mungon largpamësia e Bacës Adem: Nuk ka shqiptar, përjashtuar këta ata që e dhanë jetën gjatë kundërshtimeve ndaj robërisë një shekull e më shumë ndaj pushtuesve të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene, Jugosllavisë së AVNOJ-it, Jugosllavisë Vetëqeverisëse ku bënin pjesë edhe shumë shqipfolës që sot po bëjnë shtatë palë qejfe në Kosovën e lirë, Jugosllavisë së Zhablakut dhe Serbisë së kriminelëve të luftës, që nga Sllobodan Milloshevigi e deri te Alkesandar Vuçiqi, se që bëri i Papërsëritshmi dhe Maratonomaku i luftës për çlirim dhe bashkim kombëtar, Baca Adem Demaçi. Gjithashtu, nuk ka njeri që ka dhënë aq kontribut për komb dhe shtet e të jetë sulmuar aq shumë dhe penguar jo vetëm nga ata bastardë shqipfolës që na torturuan më shumë se vetë kriminelët serbë, por edhe nga ata me të cilët i ndau vuajtjet, idealin, sakrificën dhe ëndrrën për liri dhe të cilët ia mbyllën çdo derë dhe mundësi të jetë në vendin e merituar. Kam dëgjuar shumë njerëz të lig dhe ata që janë kundër çdo interesi kombëtar apo shtetëror se Baca Adem po manipulohet nga politikanë dhe sharlatanë, këtej e andej kufirit. Ata që nuk bënë asgjë për këtë vend, për kombin dhe njerëzimin, nuk ka si të mendojnë ndryshe, prandaj edhe jemi ku jemi, ndërkohë që kemi mundur të jemi shumë më mirë. Nuk ka pasur politikan apo njeri, parti, sistem, para, post, pasuri apo shtet që ka mundur të manipulojë me Bacën Adem nëse kjo ka qenë në kundërshtim me interesin kombëtar apo shtetëror ose që ka qenë në kundërshtim me vlerat njerëzore. Mirëpo, Baca Adem, për interes kombëtar, shtetëror apo njerëzor ka qenë në gjendje të shtrihet, të bëhet tepih mbi të cilin pafytyrësisht kanë shkelur të poshtrit që menduan se po manipulojnë me këtë vlerë universale njerëzore dhe të papërsëritshme. Të gjithë ish të burgosurit politikë mund të dëshmojnë se në Llogorin e Stara Gradishkës, ku ishin disa dhjetëra të dënuar politikë shqiptarë, Baca Adem kërkonte të përkrahej Ibrahim Rugova dhe të mos pengohej. Madje, kërkonte nga ne të mos bëhemi anëtarë të LDK-së sepse, siç thoshte, jemi me baloshë (të dënuar politikë), prandaj regjimi serb mund ta përdorë si pretekst për ta shtuar represionin ndaj LDK-së dhe vetë Ibrahim Rugovës. Me sugjerimin e Bacës Adem, shumë të burgosur politikë votuam për Ibrahim Rugovën në mënyrë që ta fuqizojmë këtë lëvizje për të cilën mendonim se do të bëjë rezistencë. Dolëm se u mashtruam keq, por Baca Adem vazhdoi t'i besonte Rugovës deri në çastin kur u bind se ky nuk është në gjendje ta bëjë edhe as një sakrificë të vetme personale duke e instaluar një frymë dhe qëndrim defetiste dhe nënshtruese. Atëherë, Baca Adem bashkë me Ahmet Haxhinë, gjeneralin Shaban Shala, disa shokë nga burgu ku isha edhe unë, e bëmë një organizim për furnizim me armë (përgjegjësinë kryesore për këtë e kishte Baca Ahmet Haxhiu). Pas krimit kundër Lagjes së Monollëve në fshatin Pollatë të Besianës, Baca Adem Demaçi ka qenë i prerë për luftë të armatosur. Baca Adem nuk ka ditur çka është frika, kur nuk ka llogaritur se çka do të ndodhë ditën që vjen. Ndonëse ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për pasojat, ai haptas e kundërshtoi Gelbardin që e cilësonte UÇK-në terroriste. Në rezidencën amerikane në Beograd, Gelbard tetë herë tha se UÇK-ja është organizatë terroriste, Baca Adem nëntë herë i tha se është organizatë dhe ushtri çlirimtare. As me Holbrukun nuk ka qenë aspak i mëshirshëm sikur as me vëllezërit Hill që çonin ujë drejt një autonomie kulturore. E refuzoi shkuarjen në Rambuje sepse në mesin e tetë pikave të panegociueshme, e para ishte se garantohej integriteti dhe sovraniteti i Jugosllavisë mbi Kosovën. U pushkatua nga shumë ish-jugosllavë dhe ish-enveristë, prijatarë e të cilëve ishin Vetoni dhe Kadareja. Sot krenohen me Rambujenë por, po ta nënshkruante Serbia këtë Marrëveshje, sot do të ishim në një situatë tjetër. E kundërshtoi Cezarin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Bernard Kushnerim, i cili i pari përligji institucionalisht korrupsionin në Kosovë duke i dhënë monopol absolut Pro Credit-it që nuk ishte fare bankë, por institucion mikrofinanciar sikur që i dha monopol të vetëm Monakos në fushën e telefonisë mobile. Kushneri donte ta përmbyllte misionin e pajtimit me Serbinë duke i rënë hekurit sa ishte i nxehtë. Baca Adem i vuri kushte duke e mbyllur këtë kapitull.

Baca Adem, kur shqiptarët ishin në rrezik, ishte shqiptari më i madh. Kur pakicat u rrezikuan pas përfundimit të luftës në Kosovë, u deklarua se është edhe vetë pakicë. Nuk kishte post që meritonte që Baca t'i sakrifikojë vlerat njerëzore në interes të njerëzimit, kombit dhe shtetit. Dha dorëheqje nga Përfaqësuesi Politik i Zyrës së UÇK-së në Prishtinë, nga kryetari i Bordit të RTK-së. Adem Demaçi ishte spiritus movens i Albin Kurtit dhe përkrahës i 100 për qind deri në çastin kur kjo u shndërrua në lëvizje politike. Nuk kishte protestë të organizuar nga LV-ja e që Baca Adem, së bashku me Shashivar Makollin-Qalin, Fexhën, Shkëmbin dhe Blinin e që nuk ishin në radhët e para. Baca Adem kundërshtoi bisedimet e Vjenës dhe Pakon e Ahtisarit sepse nuk garantonin pavarësi të plotë për faktin se krijoi Zona të Mbrojtura, decentralizim në baza etnike dhe e bënte Serbinë hisedare në Kosovë. Merreni me mend, Pakoja e Ahtisarit e bëri një Kosovë jofunksionale e mund ta →

## Nxënësit e Kamenicës protestojnë para Ministrisë së Arsimit

**Prishtinë, 3 mars (ER)** - Janë duke vazhduar kundërshtimet e reformës në arsim në Komunën e Kamenicës. Të martën pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShTI) një numër simbolik i prindërve, bashkë me nxënësit e shkollës fillore "Hasan Prishtina" nga Busavata e Kamenicës, kanë protestuar. Nxënësit e kësaj shkolle kanë mbajtur në duar pankarta me të cilat i janë drejtuar ministres së Arsimit, Hykmete Bajrami, kryetares së Kuvendit, Vjosa Osmani e kryeministrit Albin Kurti. "Vjosë e Albin, ne jemi duke vuajtur", "Duam librat tona", shkruante në disa nga pankartat që mbanin në duar nxënësit e kësaj shkolle.

Drejtori i shkollës "Hasan Prishtina" në Busavatë, Abedin Maliqi, i ka bërë thirrje MAShTI-it që ta ndalojë reformën e ndërmarrë nga kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati. "Për 72 vjet fëmijët morën dije në këtë shkollë. Nuk e pata të vështirë të jem më 11 mars të vitit 1981 në Mensën e Studentëve, nuk e pata të vështirë të jem i rrethuar së bashku me studentët në vitin 1981 nga Jugosllavia. Nuk e pata të vështirë të solidarizohem me minatorët e Trepçës. Nga 2 shtatori po e kam shumë të vështirë të gjendem përballë policit të Kosovës. Po e kam të vështirë të dal këtu sepse këtë 'gjellë' që po e përgatit Qëndron Kastrati e bën vetëm Beogradi", ka thënë drejtori Maliqi.

Ndërsa Feim Maliqi nga Këshilli i Prindërve ka thënë se nga kjo reformë po mbyllet shkolla e Busavatës e cila ka 104 nxënës.

Reforma në Kamenicë është ndarë në dy faza.

Faza e parë është aplikuar në gjysmëvjetorin e parë të këtij viti shkollor dhe ka përfshirë fshatrat Krilevë, Busavatë, Strezoc e Tuxhec. Ndërkaq, faza e dytë që edhe është pezulluar ka përfshirë fshatrat Koretin, Topanicë e Petroc.



imagjinoni se si do të duket Kosova me një Ahtisari Plus apo Ahtisar ++?! Baca Adem ishte i pari që në Beograd ua theu turinjtë shovinistëve serbë. Kur shumica e qytetarëve të Kosovës ikën nga Kosova gjatë bombardimeve, Baca Adem nuk lëvizi dhe, pa asnjë dyshim, vetëm të vdekur do të kishin mundësi ta largonin nga Kosova. Baca Adem ishte rreptësisht dhe padiskutueshëm kundër Zajednicës dhe kundër Gjykatës Speciale për Kosovën dhe kundër UÇK-së.

Krejt këtë hyrje të shkurtër e bëra për të treguar se çfarë sjellje do të kishte Adem Demaçi përballë arrogancës së Grenellit. Pa asnjë dyshim do të sillej sikur që kishte vepruar me ambasadorin Gelbard, në kohë shumë të vështira! Nuk ka sot Kosova një Adem Demaç që kishte guxim t'ua rrihte tavolinën edhe të huajve, por edhe shokëve të luftës kur ata nuk punonin si duhet. Baca Adem nuk ka duruar tereq dhe mujsharë as nëse ishin prodhime vendore e as të kontrabanduarë nga jashtë si ndërkombëtarë.

Taksa pa maska: Ramush Haradinaj së bashku me Kadri Veselin bënë historinë kur vendosën taksën 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina duke penguar një proces që ishte para aktit të kryer; atij të korrigjimit të kufijve apo rrezikimit të tërësisë territoriale të Kosovës. Ramush Haradinaj e mbrojti deri në fund, deri kur dha dorëheqje. Ramushi, por edhe të gjithë përkrahësit e kësaj takse iu nënshtruan një linçimi ndërkombëtar dhe vendor duke kërkuar që të hiqet taksa dhe të hapet rruga për bisedime me Serbinë me qëllim të arrihet një marrëveshje përfundimtare. Pas zgjedhjeve të fundit u krijua një situatë tjetër, edhe për mbrojtësit e taksës si dhe për mohuesit e saj. Thuaja të gjithë, hiç këtu AAK-në, janë për heqjen e taksës që u dëshmua edhe në seancën për taksën. Kryeministri Kurti propozoi që taksa të zëvendësohet me reciprocitet të plotë ekonomik, politik dhe tregtar me Serbinë. AAK-ja ende po kundërshton, por se mbeti e vetmuar dhe më nuk ka asnjë detyrim që të sakrifikohet për mbrojtje të taksës për faktin se fuqia politike e saj është e limituar. Ambasadori Grenell e priti në tytë të pushkës propozimin e kryeministrit Kurti duke e refuzuar krejtësisht këtë propozim. Grenelli, duke treguar muskuj dhe arrogancë, kërkon heqje të pakushtëzuar të taksës dhe refuzon çdo reciprocitet me Serbinë. Në këtë linjë janë edhe Edvin Rama, kryeministër i Shqipërisë, Hashim Thaçi, kryetar i Kosovës, Isa Mustafa (aktualisht politikani më i fuqishëm në Kosovë), Kadri Veseli, kryetar i PDK-së dhe lider i opozitës, thuaja të gjitha personalitetet më të rëndësishme e që kanë ndikim vendimmarrës si dhe Aleksandar Vuçiq, kryetar i Serbisë. Agresiviteti mujshar i Grenellit shkaktoi reagim tektonik të politikanëve shqiptarë; Rama e fyen në vazhdimësi Haradinajn, Ilir Meta e mbron ish-kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi e përdorë si armë speciale kundër Albin Kurtit, kurse ish-titistët e LDK-së po bëhen më amerikanë se vetë amerikanët, më amerikanë se Grenelli dhe Trampi. Po deklarojnë se taksa duhet të hiqet ashtu si kanë kërkuar amerikanët pa pasur asnjë ofertë konkrete, si kundërvlerë e heqjes së taksës. Albin Kurti është i gozhduar në kryqin e premtimeve elektorale dhe tani të gjithë ia ngulin nga një gozhdë për t'i shkaktuar sa më shumë vuajtje dhe për t'u dëshmuar se janë shumë amerikanë. Thellësinë dhe vrazhdësinë e nguljes së gozhdës po e masin me besnikërinë ndaj Grenellit dhe Trampit. Disa, si Edi Rama p. sh., duan t'i lajnë duart dhe ta luajnë rolin e Ponti Pilatit duke u shfajësuar nga çdo përgjegjësi. Pse domosdoshmërisht duhet t'i besojmë dhe t'i nënshtrohemi çdo diktati, kushtëzimi apo arrogance të Grenellit ose Trampit?! Çështja e Kosovës është lehtësisht e zgjidhshme; vetëm duhet të respektohen normat ndërkombëtare; janë kufijtë e përcaktuar, është territori, janë njohjet brenda këtyre kufijve etj. Kryeministri Kurti ose është dashur të mos e heq fare taksën ose është dashur ta heqë tërësisht dhe po në atë çast ta vendosë reciprocitetin me Serbinë. Po flitet për vazhdimin e bisedimeve me Serbinë dhe arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare për normalizim. Kjo nënkupton se kryeministri Kurti nuk do të ketë fare kohë dhe aspak mundësi t'i udhëheqë bisedimet për faktin se për bashkësinë ndërkombëtare lojtari kyç është Hashim Thaçi sepse është i provuar, i sprovuar dhe i dëshmuar, është pra lojtari kryesor, kurse Albin Kurti për ndërkombëtarët ende është vetëm një i talentuar i cili, nëse i dëgjon, do ta llogarisin si një yll kurse, nëse nuk i dëgjon, do ta shndërrojnë në një kometë e cila pashmangshëm do të përplaset për toke (do të eliminohet nga skena politike)! Po e vëreni se të gjithë ndërkombëtarët po e kritikojnë Kurtin për taksën, por askush nuk po e kritikon për asnjë veprim të brendshëm që e ka ndërmarrë deri më tani; shkarkimin e bordeve, të konsujve, anulimin e procesit të rekrutimit të noterëve dhe kërkesën për shkarkim të ambasadorëve.

Është një luftë e hapur midis presidentit Thaçi dhe kryeministrit Kurti, një luftë e gladiatorëve që nuk luftojnë për ta fituar lirinë, por për ta forcuar pushtetin. Duket se Albin Kurti e ka nënçmuar Hashim Thaçin duke mos e njohur as për së afërmi "Gjarprin". Albini ka menduar se Hashim Thaçi do t'ia bartë valixhet gjatë bisedimeve dhe se me kërcënime do ta frikësojë nga shkarkimi apo arrestimi. Hashim Thaçi është njeri i krizave dhe krizat vetëm sa e forcojnë! Presidenti ynë legjendar e ka të pamundur t'u mbijetojë situatave dhe gjendjeve normale dhe këtu ishte gabimi kryesor i Albinit ndaj Hashimit, në vlerësimin e situatës dhe mundësive. Hashimi u duhet shumë ndërkombëtarëve në këtë çast sikur që ndërkombëtarët i duhen Hashimit, kurse Albini është në pritje, nëse i mbijeton situatës. Albin Kurti ka bërë kthesa të mëdha në saje të korrigjimit që ia ka bërë dhe po ia bën Isa Mustafa. Prandaj edhe thashë se Isa Mustafa është politikani më i fuqishëm në Kosovë. Albin Kurtit nuk i ndihmon aspak letra informuese që ua dërgon Trampit, i cili 99.99 për qind do të jetë president edhe në mandatin tjetër dhe Grenellit për faktin se ata luajnë me Thaçin, si të duan dhe kur të duan!

Në kohën kur Grenelli e bojkoton dhe kërcënon kryeministrin Kurti, po i njëjti ambasador (Grenell) komunikon me Hashim Thaçin sikur të kishin ruajtur bashkë buallicat në livadhet e Burojës. Nuk ma ha mendja se një taksë mund t'i rrezikojë marrëdhëniet (kryesisht vasale) me amerikanët sikur që i kanë rrezikuar dhe ç'akorduar raportet, deri në prostitucion politik, të liderëve shqiptarë në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Luginë të Preshevës dhe Mal të Zi! Hashim Thaçi i ka këshilltarët e sofistikuar dhe të veshur me kostum të Makiavelit sikur që është vetë, kurse Albin Kurti i ka disa këshilltarë anarkistë që mendojnë se e ndihmojnë Albinin duke linçuar të gjithë ata që nuk mendojnë si këta dhe si Albini! Albin Kurti është i mençur, është patjetër një patriot i dëshmuar, nuk i mungon guximi dhe nuk e besoj se do të bëjë diçka kundër interesave të kombit dhe të shtetit, por duhet ta ndërpresë ta luajë rolin e Orakullit të Zeusit i cili i di të gjitha, është mbi të gjithë, nuk gabon asnjëherë dhe duhet të pyetet për çdo gjë! Nga e kaluara duhet të nxjerrë mësim nëse mendon të jetojë dhe mbijetojë në skenën politike. Është shumë herët të flitet për efektet apo defektet e qeverisë Kurti, prandaj duhet të tregohemi të durueshëm sepse gjërat do të lëvizin shumë më shpejt se që mendohet. Jam i bindur se nëse opozita aktuale dëshiron ta rrëzojë qeverinë Kurti, në këto rrethana dhe në ato që pashmangshëm do të vijnë, lehtësisht do ta bënte këtë. Mirëpo, opozita do ta bënte gabimin më të madh nëse bën përpjekje apo e rrëzon qeverinë Kurti. Opozita duhet të bashkëpunojë me qeverinë Kurti deri në kohën kur kjo do të bëhej e pamundur. Kurti ka ndryshuar retorikën, duhet t'i disiplinojë anarkistët e vendit dhe të importuar në mënyrë që edhe opozita t'i ndërrojë sjelljet. Nuk është aspak vështirë ta qëlloni se cili do të jetë rezultati i bisedimeve me një skenë aq të armiqësuar brendashqiptare të të gjitha trojeve ku jetojnë shqiptarët. Duhet të relativizohet maksimalisht agresiviteti kërcënues i Grenellit sikur që duhet të eliminohet poseviteti i presidentit Thaçi të jetë pronar i vetëm i bisedimeve me Serbinë, duke injoruar të tjerët, kryeministrin në radhë të parë! Albin Kurti ndodhet para sfidave dhe përgjegjësive të mëdha dhe duhet të përkrahet. Në rastin konkret, në çdo variant fitues është Vojvoda i Serbisë kriminale, Aleksandar Vuçiq. Nga asgjë ai do të fitojë diçka, dhe jo vetëm diçka, por do të fitojë shumë më tepër se i takon për faktin se asgjë nuk i takon. Me dyfytyrësinë e ndërkombëtarëve dhe injorancën dhe përçarjen e shqiptarëve!

# Kryetari Begaj merr mbështetje nga KFOR-i

**Malishevë, 3 mars (ER)** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe shefja e kabinetit, Blerta Krasniqi, kanë pritur në takim kolonel Nattale Gatti, komandant i Komandës së Regjionit të KFOR-it, në regjionin e Pejës, me bashkëpunëtorë. Në këtë takim Begaj dhe Gatti kanë biseduar për zhvillimet aktuale në Komunën e Malishevës, duke theksuar se gjendja e sigurisë në këtë komunë është stabile dhe e menaxhueshme. Ata kanë biseduar për infrastrukturën në arsim, shëndetësi, rrugë,



kanalizim, ujësjellës, mjedisin hapësinor e deri te çështjet politike, lokale dhe qendrore. Për të gjitha këto çështje, Begaj e ka njoftuar kolonelin Nattale Gatti, komandant i Komandës së Regjionit të KFOR-it për investimet në infrastrukturën arsimore dhe rrugore. Ndërsa kolonel Nattale Gatti e ka përgëzuar Begajn për këtë angazhim në shërbim të qytetarëve të Malishevës dhe ka ofruar bashkëpunim edhe në të ardhmen. Në fund të këtij takimi kryetari Begaj dhe kolonel Nattale Gatti kanë shkëmbyer dhurata simbolike.

# Reçani pritet të bëhet me rrjet të ri të ujësjellësit

**Suharekë, 3 mars (ER)** - Komuna e Suharekës ka bërë me dije se në fshatin Reçan të kësaj komune të martën ka filluar të realizohet projekti për rrjetin e ri të ujësjellësit. Në fillimin e punimeve të këtij projekti ka qenë i pranishëm edhe kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj. "Ky projekt po realizohet në bashkëpunim me organizatën e CDI-së e cila po e implemeton projektin që e ka financuar Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria e Kosovës", ka njoftuar Komuna e Suharekës.



# Gabimet e politikës shtetërore ndaj turizmit në Kosovë



Shkruan: Erzen GJONBALAJ

Kur fituesi i çmimit Nobel, Herman Hese, u mundua të sqarojë se problemet e reja nuk mund të zgjedhën në mënyra të vjetra, më në fund u kujtua ta gjejë zgjidhjen e këtij problemi dhe atë e shprehu përmes thënies: 'Zogu del nga veza, veza është bota'. Pra, ai që duhet të lindë duhet të shkatërrojë një botë. Mund të thuhet se Hese kishte të drejtë sepse shfrytëzoi kualitetin për ta prekur thelbin e problemit.

Një ndër problemet të cilat mbetën pa hyrë në thelbin e tyre për më shumë se njëzet vjet është fenomeni i turizmit në Kosovë. Ndoshta me "Ardhjen e ditës" do t'u mundësohet aktorëve të procesit të turizmit, qofshin teorik apo praktik, ta shfrytëzojnë kualitetin e tyre për ta prekur këtë fenomen i cili, në suazat botërore, është i shpërndarë në përmasa të gjëra dhe mund ta hasim sot në çdo cep të tokës.

Pse ngeci ky fenomen pa marrë atë çka meriton, mendojmë se problemi ishte në radhë të parë te qasja e politikës shtetërore ndaj këtij fenomeni.

Gabimi më i madh është moskuptimi, çka do të thotë me të vërtetë të udhëhiqet politika turistike e një vendi gjegjësisht moskuptimi i përmbajtjes të atyre detyrave që duhen të kryhen.

Çdokush që gjendet në pozita të tilla duhet të kuptojë se kemi të bëjmë me detyra shumë të ndërlikuara të cilat janë të lidhura me përgjegjësi të mëdha. Sipas rregullave të shkruara, politikën turistike të çdo vendi duhet ta udhëheqë organi kompetent shtetëror (ministria) dhe me siguri personi në nivelin më të lartë hierarkik që është ministri. Në Kosovë një gjë e tillë nuk ekziston por, përkundrazi, është një fenomen i cili vazhdoi duke degraduar turizmin si aktivitet ekonomik në nivelin më të lartë shtetëror.

Dikur, edhe pse nuk ishin ndoshta rrethanat që të ketë një resor ministror i cili do të merrej vetëm me çështjen e turizmit, ekzistoi Departamenti për Hoteleri dhe Turizëm në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Po t'i referohemi mënyrës së udhëheqjes së politikave të turizmit në vendet e rajonit dhe më gjerë, shohim se një pjesë të kompetencave organet më të larta qeveritare që merren me politikat e turizmit e delegojnë drejt organizatave kombëtare turistike të cilën Kosova as që nuk e ka. Dështimet në drejtimin e turizmit kanë ardhur si mungesë e organeve të tilla të politikave ekzekutive turistike (organ qeveritar) dhe atyre organizativo-propaganduese (Organizata Kombëtare Turistike) apo nga mungesa e njerëzve kompetentë të cilët do mund t'i jetësonin aspektet shkencore në udhëheqjen me aktivitetet turistike në nivelin kombëtar.

Në një kompleks të dështimeve do të duhej të përmendet, sipas mendimit tonë, se disa cilësi dhe karakteristika të tjera që merreshin për bazë që nuk kanë të bëjnë fare me turizmin dhe ishin vendimtare për t'i zgjedhur udhëheqësit të cilët drejtonin turizmin e Kosovës, siç ishte rasti me emërimin e drejtorit te Departamentit për Hoteleri dhe Turizëm në konkursin diskriminues të prillit 2007 i cili nuk kishte asgjë të përbashkët me lëmin e ekonomisë e lërë më atë të turizmit. Puna e prijësit, drejtuesit të organit më të lartë të fushës të turizmit është punë si të gjitha punët e tjerat, por ajo ka specifikat e veta jo vetëm të ketë kualifikime formale, por duhet të ketë aftësi dhe shkathtësi. Së fundi të ketë përvoja specifike në punët e një fushë të tillë. Për fat të keq, ato përvoja dhe shkathtësi nuk i pati asnjëri nga drejtuesit e organit më të lartë qeveritar sa ishte Departamenti për Hoteleri dhe Turizëm dhe ky, ndoshta, ishte shkaku se një organ i tillë u "avullua" dhe mbeti si ngushëllim i tij vetëm Divizioni i Hotelerisë dhe Turizmit.

Me të vërtetë ka qenë vështirë të pritet më shumë kur për emërime të tilla kanë vendosur personat që nuk kanë asgjë të afërt me turizmin, njerëzit politikë të cilët me dije apo pa dije këtë e bëjnë nga pozicioni politik. Tek ne të jesh politikan do të thotë viafacticka, do të thotë t'i njohësh të gjitha fushat e jetës njerëzore, pra, je ekspert i të gjitha atyre fushave, dmth. edhe për turizmin, edhe pse në fakt nuk je.

Si shembulli më i mirë i dështimit dhe fillimi i të keqes në drejtimin e fenomenit të turizmit në mënyrë institucionale ishte përzierja e politikës në zhvillimin e turizmit në Kosovë përmes ndërhyrjes në emërimet profesionale që kanë të bëjnë me politikat madhore zhvillimore, shtetërore dhe mospranimi i një programi që ishte për momentin pa alternativë me mundësi të jetësimit deri në 80 për qind i prezantuar para panelit intervistues në prill të vitit 2007. Mospranimi i këtij programi lirisht mund të thuhet se ishte diskriminim i llojit të veçantë dhe çka ishte më e keqja, asnjëri nga anëtarët e panelit intervistues nuk i takonte fushës së ekonomisë.

Ky ishte plani i aktiviteteve që planifikoheshin të realizohen në periudhën 2007 e këndej në Departamentin për Hoteleri dhe Turizëm pranë MTI-së:

- Zbatimi i politikave të cilat janë prioritete të qeverisë - MTI-së në pikëpamje të zhvillimit të turizmit;
- Përgatitja (përpilimi) e strategjive dhe planeve për zhvillim të turizmit në nivel kombëtar-shtetëror;
- Aplikimi i mekanizmave ligjorë dhe kontrollues për t'i mbrojtur turistët, formimi i inspeksioneve turistike të cilat do ta kontrollonin punën e objekteve të cilat ofrojnë shërbime hotelerie si dhe agjencitë turistike;
- Avancimi i sistemit të edukimit në shkollat e drejtimit të turizmit dhe hotelerisë, me qëllim të plotësimit të nevojave gjithnjë e më të mëdha për burime njerëzore në turizëm dhe hoteleri. Bashkëpunimi me bizneset e ndryshme turistike në qendrat e turizmit si në Ulqin ashtu edhe në qendrat turistike në Shqipëri me qëllim të aftësimit të burimeve të reja njerëzore për punë në turizëm, "kadetëve" të rinj për punë në hoteleri dhe turizëm gjatë zezonës turistike, nxitja e interesimit për nxënësit të cilët kanë suksese të larta gjatë shkollimit paraprak që të kyçen në këtë lëmë;
- Hulumtimi i tregut turistik dhe krijimi i statistikave turistike reale;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në lëmin e turizmit, vënia e kontakteve me destinacionet e njohura turistike në rajon dhe më gjerë, t'u marrim diçka nga arritjet e tyre. (Kryesisht kërkim i mbështetjes nga Republika e Kroacisë);
- Vendosja e sinjalistikës turistike në pjesët e rëndësishme, në nyjat e rëndësishme rrugore, në hyrje të shtetit (mundësisht të gjendet një donator nga jashtë, në shumë raste projektet e tilla janë mbështetur nga donatorët e jashtëm si, p.sh., në Mal të Zi; - Kujdesi për atraktivitetet turistike kulturore (turizmi kulturor), kujdesi për ruajtjen e monumenteve historike nga e kaluara dhe nga periudha e fundit - lufta e fundit (turizmi historik dhe turizmi morbil, për fat të keq u shkatërruan shumë, sidomos faktet nga burgu i Dubravës);
- Organizimi i aktiviteteve promovuese qofshin në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes shtyllave të tjera të zhvillimit të turizmit;
- Bashkëpunimi me mediumet, me qëllim që ato të mbështesin me informata, në mënyrë që ato të arrijnë sa më shpejt te shfrytëzuesit e shërbimeve turistike, organizimi i emisioneve të karakterit edukativo-arsimor nga lëmi i turizmit sidomos turizmit rural; - Aktivitete të tjera që mbështesin krijimin e ofertës turistike;
- Kërkimi për Brendin turistik, me të cilin Kosova do të dallohej nga destinacionet e tjera turistike;
- Aftësimi i popullatës lokale për t'u kyçur në rrjedhat e procesit të planifikimit dhe zhvillimit të turizmit rural, kulturor etj. (përmes seminareve dhe trajnimeve të ndryshme);
- Aftësimi-edukimi i animatorëve të turizmit rurar dhe integrimi i tyre me mjedisin ku duhet të zhvillohet turizmi rural (kryesisht pjesët rurale të Kosovës);
- Krijimi i një programi shtesë edukativo-arsimor për nxënësit e shkollave në fshat me qëllim që ata të marrin njohuri për vlerat e fshatit të tyre, komunës së tyre me qëllim që të aftësohen për punë në një veprimtari ekonomike e cila premton (turizëm rural, kulturor, shëndetësor etj);
- Organizimi i manifestimeve me karakter turistik nëpër pjesë të ndryshme të Kosovës si, p. sh., një i tillë do të ishte "Karnavali i kujtesës së qytetit" të ngjashëm me disa që organizohen në disa qytete të vogla në Evropën Perëndimore dhe në Bregdetin Adriatik, ku do të merrnin pjesë popullata lokale, mundësisht të gjitha komunitetet sipas moshave së ndryshme…;
- Organizimi i panaireve ku do të prezantoheshin krijimtaritë e karakterit turistik dhe kulturor;
- Bashkëpunimi-mbështetja e shoqatave të ndryshme të cilat me aktivitetin e tyre ndikojnë në krijimin e ofertës turistike si shoqatat e gjuetarëve, shoqatat e peshkatarëve, shoqatat e kultivuesve të shpendëve etj. Krijimi i kushteve që Kosova një ditë të shpallet vend i gjuetisë dhe të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare të gjuetisë dhe njëherësh të radhitet në destinacionet ekskluzive të turizmit të gjuetisë;
- Pozicionimi i disa zyrave informative të cilat do t'u ofronin turistëve potencialë informata për të cilat ata shprehin interesim;
- Krijimi-publikimi i një "Guide" turistike për turizmin e Kosovës;
- Brengat-kujdesi për ruajtjen e ambientit jetësor (ruajtja e lëndës së parë turistike-ruajtja e llojeve endemike të botës bimore dhe shtazore). T'u kushtohet kujdes më i madh atyre pjesëve të diversiteteve të cilat janë para zhdukjes;
- Zëvendësdrejtori i këtij departamenti të emërohet nga komuniteti serb, me qëllim që më lehtë të penetrojmë në kompleksin turistik në Brezovicë;
- Zyra e departamentit do të zhvendosej në Shtërpce meqë potencialet turistike për momentin ishin të koncentruara aty, pavarësisht se aty popullata vendore shumicë i përket komunitetit serb. Ky fakt u ilustrua me një shembull nga Mali i Zi, gjegjësisht nga Ulqini, i cili me shumicë popullatë shqiptare, resurset turistike i menaxhon Podgorica, çka dmth. se me Brezovicën duhet të udhëhiqet nga Prishtina çka një zonjë nga paneli intervistues e komuniteti serb nuk i pëlqeu një gjë e tillë dhe si pasojë u "diskualifikua", autori i këtij projekti - kandidatit për kreun e turizmit dhe hotelerisë të asaj kohe dhe kjo ishte arsyeja e mospërfilljes së kësaj ideje dhe që iu komunikua "dikur" gojarisht shumë kohë më vonë nga kryesuesi i panelit intervistues dhe ishte shumë qesharake: "Ia ngrite tensionin zonjës së komunitetit serb".

*(Autori është turizmolog-hulumtues i turizmit erotik dhe turizmit rural.* ***Vijon****)*



*Peizazhi i bukurive natyrore të Alpeve Shqiptare, pika e tretë e kufirit (KS - AL -MNE). Natyra i dhuroi këto bukuri të cilat njeriu nuk po mund t'i valorizojë. /Foto 08.02.2020. Enes Psk Hrid Drešković)*

# AKUZA E NJË GRUAJE INTELEKTUALE

Mehmet HAJRIZI

1
Ky publikim është një protestë dhe akuzë kundër një lufte të ndyrë të fundshekullit të kaluar që bëri regjimi serb i Milosheviqit famëkeq ndaj grave dhe vajzave shqiptare në Kosovë. Institucionet e dhunës të këtij regjimi mizor kur përdhunuan femrat shqiptare kishin për qëllim thyerjen morale të popullit që po i rezistonte, kur vranë 1392 fëmijë donin t'ia gjymtonin edhe të ardhmen dhe kur i dogjën 120 000 shtëpi, shpesh me njerëz brenda, bënin gjenocid, duke deportuar dhe zhbërë një popull të tërë nga vatra e vet.

2
Autorja shkrimin e saj e ka ndarë në gjashtë njësi tematike, duke filluar nga pushtimi serb i Kosovës dhe gjeneza e armiqësisë shqiptare-serbe, në thelb të së cilës janë ndarja si me thikë e atdheut shqiptar dhe kalvari shekullor i një populli të tërë e rezistenca e tij kundër aneksimit të dhunshëm. Kjo rezistencë e pashuar gati një shekull, me ngritjet dhe rëniet e saj erdhi ngadhënjyese në kapërcyell të shekullit XX, kur Kosovës iu imponua lufta e armatosur, por edhe botës demokratike intervenimi ushtarak.
Në pjesën e dytë të shkrimit paraqitet dhe analizohet vetëm njëri aspekt i luftës së forcave serbe kundër Kosovës, ai më kriminali në kuptimin shqiptar, dhunimi seksual i mbi 20.000 grave dhe vajzave shqiptare. Kjo shifër në përpjesëtim me një popullsi prej rreth dy milionë banorëve, tmerrësisht flet shumë. Në dy pjesët vijuese autorja e trajton këtë shëmti si gjenocid biologjik, mjet lufte dhe krim kundër njerëzimit. Në dy pjesët e fundit ndërkaq, ajo fajëson faktorët e jashtëm që nuk zbatuan të drejtën ndërkombëtare për këtë krim, në një anë dhe institucionet e vendit që nuk e dëshmuan as e denoncuan atë mjaftueshëm, në anën tjetër.
Shkrimi është i pajisur me aparaturën e nevojshme shkencore, i argumentuar mirë dhe me përmbajtje të qartë e stil adekuat të shkruarit.

3
Që nga lashtësia ka zënë fill bindja se një ushtri që si mjet dhe formë lufte aplikon përdhunimet, është e destinuar për humbje.
Kjo dhunë seksuale në stil të gjerë në Kosovë, si armë lufte e forcave serbe, dëshmon gjithë karakterin e tyre, por edhe të politikës që i drejtonte.
Një ndër virtytet e larta gjenetike të shqiptarëve, është familja, si institucioni bazë i shoqërisë. Jo rastësisht doktrina antishqiptare e përpunuar gjatë nga intelektualë dhe politikanë serbë, synonte ta godiste qenien shqiptare në palcën kurrizore; familjen, nderin, dinjitetin dhe krenarinë kombëtare.
Në shënjestër të detashmenteve sulmuese të forcave burracake dhe qyqare serbe në Luftën e Kosovës, në plan të parë ishin civilët, fëmijët, pleqtë dhe femrat. Ato jo vetëm nuk kishin moral luftarak të ndesheshin me luftëtarët e luftëtaret e uniformuar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por as moral minor njerëzor. Një ushtri që vret fëmijë me biberon në gojë dhe dhunon seksualisht gra dhe vajza të pambrojtura, është e dënuar me vdekje. Dhe jo vetëm kaq; ata duke cenuar moralin kombëtar shqiptar, vunë në bankën e të akuzuarit para historisë e ndërgjegjes së njerëzimit, brez pas brezash moralin dhe dinjitetin e kombit dhe shtetit të vet.



4
Nuk dua të besoj se kjo sjellje skizofrene është defekt a patologji kombëtare serbe, por mbaj mend një djalë birbo kriminel serb, kur ndodhesha në një dhomë me të dhe të tjerë në Burgun Hetues të Novi Sadit. E pyetën një rast kolegët e vet të dhomës, cila ishte dëshira e tij më e madhe. Prisja të thoshte ta lironin nga burgu, por jo. „Dëshiroj ta kisha një vajzë të bukur, ta përdhunoja me fuqinë e mashkullit dhe në fund ta varja për këmbësh dhe dalëngadalë ta rripja e mishin t'ia bëja copë-copë"! E dëgjoja dhe e psikologjisja, por ai fliste ftohtë, pa i kërcyer ai nervi facial në vragë dhe bënte me duar, sikur ta shkërmoqte vërtet viktimën. Më bëri të mendoja gjatë ai djalë me shpirtin e tij; prej nga kjo ide, kush ia tha, ku e lexoi, apo ishte imagjinatë morbide e vetja? Për një çast mendja më shkoi te vajzat shqiptare në një lëndinë tek po loznin si qengjat engjëllushe... Mora ta lexoja një libër...




5
Elife Luzha, një grua e vuajtur dhe që në vajzërinë e saj të hershme e përndjekur nga regjimi për pjesëmarrje në demonstratë dhe për shpirtin liridashës, tani magjistrate e diplomacisë, intelektuale krijuese dhe poete e njohur, ka ngritur zërin kundër padrejtësive që u bëhen grave dhe sidomos kundër dhunës seksuale të ushtruar kundër tyre gjatë Luftës çlirimtare. Me ndjeshmërinë e gruas nënë dhe për më shumë të poetes, Elife Luzha e trajton këtë plagë të rëndë të luftës, si një gjëmë që i kishte ndodhur Kosovës së saj. Nga gjithë tmerri dhe llahtari i këtij krimi të veçantë, ajo sjell rrëfimet tronditëse vetëm të dy të rejave shqiptare, si prototipe edhe të 20 mijë të mbijetuarave të tjera që lotët si vrer gëlltisin çdo ditë, siç thotë autorja në poezinë e saj kushtuar grave të përdhunuara. Janë megjithatë edhe 1739 gra shqiptare që nuk i mbijetuan terrorit të forcave serbe, duke u bërë theror në themelet e lirisë së Kosovës.
Autorja bën thirrje me zërin e nënës që të mos heshtet e të dhunohet e vërteta, sepse bëhet kështu një krim i dytë mbi gratë e vajzat që përjetuan dhunimin seksual gjatë luftës, por edhe sepse ashtu pamundësohet trajtimi dhe rehabilitimi i tyre. Krimi duhet denoncuar dhe dënuar!
Ky publikim është në vazhdën e kontributit të autores në këtë temë të dhembshme, për këtë plagë të pambyllur të luftës.

6
Presidenti serb, që gëzon simpati dhe përkrahje të gjerë në popullin e vet, para do kohe, në stilin e tij, përveç krimeve të tjera, e mohoi edhe këtë krim monstruoz të forcave të shtetit të vet kundër grave shqiptare. Populli serb ka nevojë ta pastrojë këtë njollë të zezë nga biografia dhe historia e vet. Ky lavazh fillon me ballafaqimin me krimin, me kërkim faljen e sinqertë dhe me denoncimin e dënimin e tij dhe të atyre që e bënë, për gjëmën e shqiptarëve dhe të zezën e vetë serbëve. Sa më parë, aq më mirë.



# Poezi e obsesionit estetik dhe e panikut postmodernist

Milazim KRASNIQI

Vëllimi poetik më i ri i Sali Bashotës shënon kulminacionin artistik të tij si poet, duke na ofruar edhe një mundësi të rishikimit dhe rivlerësimit të gjithë krijimtarisë poetike të tij, që tashmë ka hyrë në dekadën e katërt. Nga "Albumi i grisur" (1986) e deri te vëllimi më i ri, ndërmjet të të cilëve janë edhe vëllimet "Zogu me profil vjeshte" (1989), "Plagomë" (1994), "Dalje nga trishtimi" (1999), "Bukuri e nëmur " (2006), "Dorëshkrimi i ngjallur " (2011), "Në fillim ishte Drita" (2017), "Asnjë zë tjetër " (2018), poezia e Saliut ka ndjekur një rrugë konstante ambicioze të evoluimit artistik, duke alternuar shqetësimet motivore e tematike, sigurisht nën ndryshimet që kanë ndodhur në jetën personale e shoqërore, por duke mbajtur të pandryshuar obsesionin e komunikimit si një idealizëm estetik, në morinë e komunikimeve rivale ndërpersonale.

Në këtë linjë vështrimi të gjitha vëllimet e deritashme përbëjnë një strukturë të obsesionit estetik të tij. Edhe vëllimi "Lutja e parë e shpirtit" (2020) inkuadrohet në këtë strukturë, sigurisht duke e pasuruar atë me zhvendosje e pranëvendosje vlerash artistike, po edhe duke u imponuar si element dominues në atë strukturë komplekse falë kulminacionit të vlerave estetike me të cilat merr pjesë.

Këtu, në këtë pikë konstatimi, jam i dyzuar ndërmjet dy opinioneve të dy studiuesve të njohur, Emil Shtajgerit dhe Jan Mukarzhovskit, që ofrojnë dy mundësi të kundërvëna të shikimit të statusit dhe të strukturës së produktit poetik. Shtajgeri pohonte, në një rast, se secila poezi është vepër artistike më vete, e pavarur nga të tjerat në të njëjtin vëllim poetik, pra funksionon edhe si strukturë e mbyllur. Ndërsa Mukarzhovski pohonte se veprat e të njëjtit autor formësojnë një strukturë unike brenda së cilës ndodhin zhvendosje, por duke u ruajtur uniteti i saj.

Pa e minimizuar aspak qëndrimin imanent të Shtajgerit, me këtë rast do ta ndjek qasjen me Mukarzhovskin, sepse më duket më e dobishme për ta hetuar evoluimin e poezisë së Sali Bashotës, e cila ka shumë elementë që barten dhe pranëvendosen nga vepra në vepër, duke e pasuruar tërësinë e duke përjashtuar vetëm ato elemente që tregohen më pak dinamike estetikisht. Mukarzhovki thotë: "Zhvillimi i strukturës individuale të veprës së autorit nuk është i tillë që ta mundësojë ndryshimin e strukturës me kërcime të papritura: kontinuiteti i saj nuk ndërpritet as nga ndryshimet radikale, gjithmonë ekziston rivaliteti ndërmjet asaj që mbetet dhe asaj që vazhdon, prandaj edhe autori është i mbyllur në kufijtë e individualitetit të vet, të cilin me veprën e vet, në të vërtetë, e përsos pandërprerë, por pikërisht për këtë arsye nuk mund të dalë jashtë kufijve të saj" (Mukarzhovski: 207).

Pra, ndonëse vëllimi më i ri, vërtet paraqet kulminacionin e krijimtarisë poetike të Bashotës, ai mbetet brenda kufijve strukturorë të mëparshëm, sigurisht duke provuar që ta përsosë sa më shumë vargun poetik, pa hequr dorë nga trashëgimia paraprake. Ky fakt vërehet qartësisht në format e titujve të poezive, në formën grafike të vargjeve, në shumë elementë stilistikë, në disa nga motivet qendrore dhe në objektivin qendror të komunikimit, që mbetet me synimin e një komunikimi relativisht të ulët, diskret, gati inhibicional, gjë që bartet si strategji poetike nga vëllimet e mëhershme.

Një vlerë konceptuale, ideologjike dhe estetike e re që imponohet më shumë në vëllimin e ri është një reagim brenda të ashtuquajturit paniku postmodernist. Pra, theksimi i humbjes së sigurisë së individit dhe kërkimi në panik i saj është një vlerë që tashmë duket sikur konkurron më guximshëm me shtresat e vjetra të vlerave konceptuale, ideologjike dhe estetike të poezisë së Bashotës. Poezia "Parandalimi i vdekjes" inicion këto shtresëzime, me elemente tipike të panikut postmodernist:

*Sytë e kaltër të ëndrrës*
*I dua shumë*
*Si ty*
*Si ty*
*Si ty*
*Por ti nuk je përmallim i djegur*
*Nuk je as frikë*
*Nuk je as ikje*
*Nuk je as dhimbje*
*Mollëzat e përflakura të vetmisë*
*I dua shumë*
*Si ty*
*Si ty*
*Si ty*
*Por ti nuk je dashuri e çmendur*
*Nuk je as mëkatare*
*Nuk je as hije*
*Nuk je as vdekje e bukur*

Ky është një ligjërim poetik tipik me tharmin e panikut postmodernist brenda ligjërimit, madje edhe dukjes grafike. Subjekti lirik i stresuar tenton të gjejë shtigje të reja të njohjes, të shpëtimit nga paniku, qoftë duke evokuar dashurinë si vlerë sublime humane, qoftë duke evokuar ëndrrat, qoftë duke u mbështetur në iluzione e vizione të brishta, që shpërbëhen dhe që vetëm ideja fikse (që mishërohet në vargjet: *si ty, si ty si ty*) arrin t'i mbajë pezull.

Në këtë kërkim të rrugëve të njohjes e të shpëtimit, tashmë përfshihet edhe Transcendenca, sado që jo si instancë e njohjes, po si element i emocionit, më saktë panikut. Fjala vjen, operohet me nocionet libër dhe testament që kanë të bëjnë Librat e Shenjtë, por autori vetëm i evokon si nocione, ndërsa shmang referimin e ligjërimit poetik në to si instanca denotative, gjë që sërish më duket si intonacion i panikut postmodernist:

*Libri i ëndrrave*
*I vetmi testament*
*Për një lutje*

Por, ka edhe raste kur ka më shumë qartësi konceptuale në këtë kërkim, në disa poezi të këtij autori, fjala vjen në poezinë "Tri pika":

*Pika e parë*
*Shpirti i saj*
*I mëshiruar nga Zoti*

*Pika e dytë*
*Fytyra e saj*
*E mishëruar nga Zoti*

*Pika e tretë*
*Buzagazi i saj*
*I mëshiruar nga Zoti*

Ligjërimi më i shtruar, më vizionar, vërehet lehtësisht në këso rastesh sesa në rastet kur kombinohen përfytyrimet, idetë, përjetimet nga sfera të ndryshme jetësore e botëvështrimore të kundërvëna. Në fakt, ky është një nga problemet më të mëdha që ka e gjithë poezia shqipe e modernizmit, po edhe e postmodernizmit, pra një eklektizëm konceptesh e vlerash të kundërvëna, që nxirren nga shtrati natyral dhe futen në njëfarë shtrati prokrustial. Është pasojë e doktrinave dhe rrymimeve të kundërvëna, të pafiltruara, të pahierarhizuara, të pavlerësuara qartë, gjë që pothuajse pashmangshëm shpie drejt përjetimit agnosticist të botës. Postmodernizmi është truall shumë i pëlleshëm për këso pranëvendosjesh dhe këso eklektizmash. Prandaj, komunikimi më frytdhënës me publikun dhe transmetimi i një

vizioni estetik më imament e më koherent për njohjen, në këtë kontekst, mbetet sfidë serioze.
Sidoqoftë, kjo ndjeshmëri postmoderniste në poezinë më të re të Bashotës e pasuron atë koncetualisht dhe artistikisht. Brenda kësaj ndjeshmërie janë edhe mikronarracionet e subjektit lirik mbi dashurinë, vetminë, ëndrrat, hutimin, rezingantën, por edhe ironia që, ndonëse jo shumë e dendur, ka raste që bashkohet në këtë frymë konceptimi postmodernist, si në poezinë: "Ideali i dyfishtë", ku dominon ironia ndaj atyre që abuzojnë lirinë, duke qenë megalomanë, egoistë, kleptomanë dhe faqezi:

*Unë jam më i vogli*
*Të mëdhenj jeni ju të tjerët*
*Që mbartni mbi supe lirinë*
*Asnjë stuhi nuk iu ndal*
*Asnjë fuqi e gravitacionit të tokës*
*Që vërtet të dukeni të mëdhenj*
*Shumë të mëdhenj sa të çmendeni*

Mirëpo, në poezinë e Saliut shumë shpesh paniku postmodernist kombinohet me idealizmin modernist, më saktë me konceptimin romantik për poetin si një lloj demiurgu, i cili ka rol të veçantë dhe, mbase, edhe mistik në misionin e tij për ta zbuluar të bukurën në natyrë, në jetë dhe veçmas në gjuhë. Poeti mbetet për Bashotën një institucion që humanizon, që transmeton fisnikëri e dhimbje, ndonëse mbetet i moskuptuar.

*Të jesh vetëm poet do të thotë të jesh dhimbje e përflakur*
*Përgjithnjë në tokën e zezë*
*Përgjithnjë në detin paanë*
*Përgjithnjë në qiellin pa yje*
*Të jesh vetëm poet*

Ose:
*Askush nuk i duron poetët*
*Ata janë si lumenjtë e qiejve*
*Që rrjedhin brigjeve të amshimit*
*Askush nuk i duron poetët*
*Kur thurin vargje për vuajtjen e tjetrit*
*E për vete protestojnë vetminë e tepërt*
("Askush nuk i duron poetët")

Ndonëse ky konceptim është brenda kornizës moderniste romantike, në tërësinë e ligjërimit, edhe ky më duket sikur ligjërim paniku, duke denoncuar çrregullimin në komunikimin e individit me shoqërinë. Ligjërimi poetik me intonacione të larta, gati me klithma, e bën bindës këtë konceptim. Sikundër që pohonte Llotmani, "nuk udhëheq vetëm tema shenjën gjuhësore, por edhe shprehja gjuhësore udhëheq temën" (Llotman: 94.) Pra, kjo do të mund të thoshte kështu: koncepti për poetin si iluminues e si ëndërrimtar mbetet aktiv, por ligjërimi gjuhësor-poetik i ndryshuar për të, ndikon që edhe ai status të shihet si i ndryshuar. Saktësisht siç është në realitetin jetësor!
Për ta bërë sa më të qartë këtë raport, po ju njoftoj se cikli "Imazhi i pestë Dhimbja", me vënien e imazhit në plan të parë, i cili sikundër dihet është elementi më i ekspozuar i përjetimit postmodenist të jetës/botës, dëshmon se Bashota tashmë ka avancuar shumë në ligjërimin me këtë frymë. Intonacionet e pasuruara të vargut, të bashkuara me nivele të tjera të ligjërimit poetik, në mënyrë intuitive marrin përsipër të bëhen shenja të realitetit të kohës në të cilën jetojmë në panik, ndërmjet kaosit e anarkisë, antivlerave dhe dehumanizimit. Llotmani ka sinjalizuar moti: "Për shqyrtimin e korrelacionit ritmik të intonacionit dhe semantikës së vargut, si pikë nistore duhet të shërbejë bindja që rendi ritmik-intonativ nuk është strukturë e pavarur, por është element që shërben për një varg nënstrukturash të cilat në bashkëveprim konstituuojnë sistemin unik të tekstit, i cili quhet poezi dhe i cili paraqet shenjë të përmbajtjes së caktuar dhe model të realitetit të caktuar (Llotman: 247)
Falë përvojës së gjatë si poet dhe si studiues i pasionuar i letërsisë, Sali Bashota është autor që i njeh këto vibracione intonative-ritmike, ideologjike, stilistike e sociale, prandaj edhe arrin t'i definojë gjuhësisht në pajtim me realitetin.
Këso përcaktimesh ka edhe për motive të tjera, veçmas për motivin e dashurisë, që është motivi dominues në këtë vëllim dhe veçmas në vëllimin pararendës të autorit. Ja një shembull definimi impresiv poetik:

*Dashuria është si trëndafil i bardhë*
*Me trup të drejtë*
*Dashuria është si zjarri i ndëshkimit*
*Me shumë të panjohura*
*Dashuria është si gjumi i shpirtrave*
*Në mesnatën e lumturisë*
("Dashuria", *Kushtuar atyre që dinë çdo gjë për dashurinë)*

Nëse do të bëja një klasifikim të vogël të poezive antologjike të këtij vëllimi, në të do të përfshija këto poezi, ose vepra të veçanta artistike, (këtu sërish ripajtohem me Shtajgerin): "Bukuria", "Të jesh vetëm poet", "Gjethet s'bien gjithmonë në tokën e vet", "Si lind poezia për ty", "Liria", "Ideali i dyfishtë", "Askush nuk i duron poetët", "Njësoj si sytë e tu" , po edhe disa të tjera nga ky vëllim voluminoz.
Një vëllim poetik që ka kaq poezi antologjike brenda dy kapakëve, ia vlen të lexohet qoftë dhe vetëm për to. Ndonëse në rastin e këtij libri, i tëri është i këndshëm për lexim dhe ofron një përjetim mirëfilli artistik. Bile në këtë kontekst, poezia e Bashotës ende ka mbetur me njërën këmbë jashtë ligjërimit postmodernist, i cili zakonisht është më eksplicit, më sipërfaqësor, më vulgar, më pak domethënës e më pak mbresëlënës. Shumica e poezive të tij përshkohen nga poetizma dhe figura që prodhojnë emocion, ndjeshmëri morale dhe përjetim estetik.
Si lexues i vëllimit, derisa ishte në dorëshkrim, e kam lexuar me sytë e mi e jo me sytë e autorit. Aq më pak me sytë e lexuesve të ardhshëm. Prandaj, leximi im që po u ofrohet këtu si parathënie, mund të jetë një urë lidhëse ndërmjet autorit dhe lexuesve, por kjo nuk është fare e domosdoshme. Lexojeni vetë, përjetojeni vetë. Ndërsa autori më nuk ka të bëjë me mënyrën se si ne e lexojmë dhe e vlerësojmë poezinë e tij. Ai ka bërë mjaft, na e ka afruar mundësinë që të komunikojmë me të. Kjo është zemërgjerësia e poetëve të vërtetë, të cilën komunikuesit e tjerë, nuk e kanë në këtë formë e në këtë nivel.

*(Parathënie e librit "Lutja e parë e shpirtit", PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2020)*


Vëllimi poetik më i ri i Sali Bashotës shënon kulminacionin artistik të tij si poet, duke na ofruar edhe një mundësi të rishikimit dhe rivlerësimit të gjithë krijimtarisë poetike të tij, që tashmë ka hyrë në decenien e katërt. Nga "Albumi i grisur"(1986) e deri te vëllimi më i ri, ndërmjet të të cilëve janë edhe vëllimet: "Zogu me profil vjeshte" (1989), "Plagomë" (1994), "Dalje nga trishtimi" (1999), "Bukuri e nëmur" (2006), "Dorëshkrimi i ngjallur" (2011), "Në fillim ishte Drita" (2017), "Asnjë zë tjetër" (2018), poezia e Saliut ka ndjekur një rrugë konstante ambicioze të evoluimit artistik, duke alternuar preokupimet motivore e tematike, sigurisht nën ndryshimet që kanë ndodhur në jetën personale e shoqërore, por duke mbajtur të pandryshuar obsesionin e komunikimit si një idealizëm estetik, në morinë e komunikimeve rivale ndërpersonale.

Milazim Krasniqi

* * *

Poezia e Bashotës është përmasë e enigmës. Nuk është masë e dukshme që tregon marrëdhënien ndërmjet materies dhe shpirtit, për një çast, natyrisht thellësisht poetik, ajo zgjedh frymën lirike të vargjeve, që na shoqërojnë kudo me butësinë dhe dramaticitetin përjetues. Është nga poetët e veçantë që ndjen plotësisht arsyen e krijimit të mesazheve për botën që e kishte njohur dhe me të cilin kishte ndërtuar një marrëdhënie të papërfunduar. E fundja, poetët nuk përfundojnë asnjëherë vizatimin e kufirit të botës që ndan të kaluarën nga e tashmja dhe të tashmen nga e ardhmja. Këtë nuk e bënë poeti, edhe për arsye të mbajtjes së zgjuari një fushë të gjerë loje lirike, pasi lirizmi i tij është shpirtërorja e materializuar në të vetmin testament që ai e shkruan dhe kondenson. Kjo është fuqia për të transmetuar lutje.

Ibrahim Berisha

Çmimi 9 €

ISBN 978-9951-457-50-7

SALI BASHOTA | LUTJA e PARË e SHPIRTIT

Kosova PEN Center

SALI

BASHOTA

LUTJA e PARË e SHPIRTIT

Kosova PEN Center

E jashtëzakonshme

## Nga 44 metra lartësi hedhin veturën mbi trampolinë



Një ish-inxhinier i NASA-s dhe dy të rinj që janë bërë të famshëm me videot e tyre në 'YouTube', pasi kanë hedhur një veturë nga 44 metra lartësi mbi "trampolinën më të fuqishme në botë". Shkencëtari Mark Robert i kaloi gjashtë muaj duke planifikuar në detaje këtë eksperiment. Ai ndërtoi trampolinën dytonëshe prej çeliku dhe gomës të cilën e mori nga pjesë të ndryshme të një garazhi të vjetër. Interesant është se si vetura amortizohet dhe përfundon në tokë, duke i rezistuar trampolina kësaj peshe të madhe.

FOTO E DITES



Punëtorët në një fabrikë të Kinës shihen duke punuar me kostume mbrojtëse si shkak i koronavirusit. /AP/

E rrallë

## 13-vjeçari që e tallnin se preferonte librat, bëhet me 170 000 ndjekës në 'Instagram'



Një 13-vjeçar që ngacmohej dhe tallej në shkollë për llogarinë e tij në "Instagram" ku fliste për librat e preferuar, duket se është ai që po qesh i fundit pasi ka fituar më shumë se 170 000 ndjekës. Britaniku Callum Manning nisi faqen e tij në 'Instagram' të quajtur Cal's Book Account, ku rekomandonte librat e pëlqyer prej tij edhe për miq të tjerë. Por fëmijë xhelozë të shkollës së re nisën të dërgonin mesazhe ofenduese dhe ai kishte mbetur "i shkatërruar".

## BARSOLETA E DITËS



**Djali: Alo, Agim, a je ti?**
**Policia: Jeni gabim, zotëri!**
**Djali: Pse po bërtitni pra?**
**Policia: Kujt i thoni kështu?!**
**Djali: Juve more!**
**Policia: A e dini se me kë po flisni?**
**Djali: Jo. Kush jeni ju?**
**Policia: Drejtori i policisë rajonale.**
**Djali: Po ju, e di se me kë po flisni?**
**Policia: Jo.**
**Djali: Shyqyr.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 18:00**

### Spies in Disguise 3D




I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno




**Në ora 18:00**

### Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
**Regjia:** Jake Kasdan

**Çdo natë në ora 20:00**

### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D




Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
**Regjia:** J.J. Abrams




**Çdo natë në ora 22:30**

### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Duhet ta mbani nën kontroll ambicien tuaj. Nuk ka kuptim të merrni më shumë projekte nëse nuk keni energji për t'i çuar deri në fund.



**DEMI**
Është koha që sot të shtoni një hapësirë të vogël frymëmarrjeje në orarin tuaj! Ju keni qenë me nxitim kohët e fundit.



**BINJAKËT**
Mos lejoni qe përgjegjësia, frika dhe ndjenjat e fajit t'ju udhëheqin në rrugën tuaj Përkundrazi, lëreni fantazinë dhe shpresën të jenë udhërrëfyesit tuaj.



GAFORRJA
Do të kaloni një ditë të shkëlqyeshme duke nisur nga mëngjesi. Ju jeni duke u bërë një paqebërës i mrekullueshëm.



**LUANI**
Në çdo lloj konflikti që mund të keni sot, përpiquni të përqendroheni në faktet dhe shifrat e situatës në fjalë, jo në emocione.



**VIRGJËRESHA**
Nëse ndiheni luftuese në fillim të ditës, mos mendoni se kjo ndjenjë do të zgjasë tërë ditën. Pajtohuni për një kompromis dhe ju do të ndaloni së ndjeri nevojën për të luftuar.



PESHORJA
Një nga marrëdhëniet tuaja personale mund të shndërrohet në një marrëdhënie biznesi, dhe kjo është një gjë shumë e mirë për të dy.



**AKREPI**
Gjërat po duken mirë për ju sot nëse përpiqeni të filloni diçka si një punë e re, një udhëtim, ndonjë lloj projekti arti ose një rutinë fitnesi.



**SHIGJETARI**
Bota është plot mundësi që ju të rriteni sot, kështu që përpiquni të gjeni pak kohë pasdite, për të përfituar nga të paktën një prej tyre!



BRICJAPI
Tani nuk është koha për të bërë blerje të çmendura ose për të shpenzuar shumë para. Dëgjoni anën tuaj më praktike.



**UJORI**
Kur mundësia troket, jo gjithmonë duhet ta hapësh derën. Kini kujdes që të mos bëheni një person i cili gjithmonë thotë po.



PESHQIT
Ju do ta keni përgjigjen për një problem tuajin. Këshilla për ditën e sotme është që të mos tregoni drojë dhe turp.

# Siguria fizike e çiftit mbretëror, Kanadaja heq dorë nga detyrimet



Qeveria kanadeze ka konfirmuar se në muajin prill nuk do të këtë më përgjegjësi për sigurinë fizike të çiftit Meghan dhe Harry në momentin që ata do ta nisin jetën e tyre të re larg familjes mbretërore. Policia kanadeze deri më tani ka asistuar në bazë të një marrëveshje për sigurinë e çiftit mbretëror. Por më 31 mars kur fillon një kapitull i ri për Meghan dhe Harryn, marrëveshja përmbyllet. "Duka dhe Dukesha aktualisht njihen si Persona të Mbrojtur Ndërkombëtarë dhe Kanadaja ka një detyrim ligjor të ofrojë ndihmë sigurie. Por mbrojtja nuk do të ofrohet më në javët në vijim, në përputhje me ndryshimin e statusit të çiftit", thuhet në një deklaratë të lëshuar nga Zyra Kanadeze e Ministrit të Sigurisë Publike.

# Dieta, stili i jetesës dhe sekretet e Halle Berryt



E diagnostifikuar me diabetin e tipit '2 qysh' në moshën 19-vjeçare, Halle Berry ka qenë vazhdimisht para sfidës së madhe për ta mbajtur nën kontroll shëndetin e saj. Ajo në moshë të re e ka kuptuar se duhet të kujdeset për regjimin ushqimor dhe trupin e saj, derisa këtë gjë tani duket se e bën lehtësisht. Aktore e talentuar, nënë e mrekullueshme, mike fantastike, Halle Berry është një inspirim për shumëkënd. Shpeshherë ajo ka ndarë sekrete të vogla me fansat në llogarinë e saj në "Instagram", të cilët janë 3,3 milionë.







# Jennifer Lopezi shfaqet kreative me fustanin e "Versaces"

Njëzet vjet më parë Jennifer Lopez shokoi tapetin e kuq të Grammyt me fustanin e gjelbër "Versace", të cilin, pasi e riktheu sërish në qendër të vëmendjes pak kohë më parë, e ka bërë së fundmi pjesë të gardërobës së përditshmërisë. Jennifer u pa në Miami e veshur me pantallona dhe këmishë me të njëjtat printe. Çanta e vogël gjithashtu u frymëzua nga fustani ikonik. Jenniferi e kompletoi veshjen me një palë atlete të bardha "Versace" dhe syze me shkëlqim të gjelbër.

# Ashton dhe Mila pranojnë dhuratë nga Netflix



Ashton Kutcher janë fansa të mëdhenj të serialit në Netflix "Cheer", aq sa ky shërbim u dërgoi atyre një paketë nga ekipi Navarro Cheer. Aktori 42-vjeçar postoi një fotografi të paketës që ai sapo e pranoi me postë, e cila ishte e mbështjellë me një lidhëse Netflixi. Ende nuk dihet se çfarë kishte brenda. "Mila dhe unë zyrtarisht jemi duke u 'çmendur' nga gëzimi", shkroi Ashton në postimin e tij. Letra në paketë thotë: "Ashton + Mila, ne dëgjuam se jeni fansa! Mbështetja juaj ka rëndësi të madhe për ne. Nga Netflix + Navarro Cheer Team".




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Ballkani - Dita 'luftojnë' për pozitën e parë

Derbi në mes të Ballkanit dhe Dritës shihet si një garë për pozitën e parë në elitën e futbollit të Kosovës. Jetmir Topalli ka thënë se skuadra e tij do të dalë triumfuese, derisa të njëjtin parashikim për "Epokën e re" e ka dhënë edhe sulmuesi i Dritës, Astrit Fazliu



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 MARS - Lideri aktual i IPKO Superligës në futboll, Ballkani, e pret sot (e mërkurë) skuadrën e Dritës. Në fakt, këto dy skuadra janë të parat në renditjen tabelore dhe ndër favoritet kryesore në garë për titullin të kampiones. Suharekasit e drejtuar nga Ismet Munishi për këtë ndeshje do të kenë dy mungesa të mëdha të formacionit të parë: Kushtrim Gashi dhe Jetmir Topalli. Ky i fundit për gazetë ka thënë se ndihet keq që nuk mund të paraqitet në këtë ndeshje shumë të rëndësishme, por beson se Ballkani do të dalë fitues në fund. "Më mbetet merak që nuk do të kam mundësinë t'u ndihmoj bashkëlojtarëve, pasi është një ndeshje derbi me rëndësi të madhe. Megjithatë, besoj se kushdo që luan në vendin tim do ta japë maksimumin dhe Ballkani në fund do t'i gëzohet fitores", ka thënë Topalli, i cili mungon për shkak të kartonëve. Mirëpo lajm i mirë për trajnerin Munishi është rikthimi i mbrojtësit Besnik Krasniqi që mungoi në përballjen e fundjavës së shkuar kundër Prishtinës. Për ndeshjen e sotme ka folur edhe sulmuesi Astrit Fazliu, i cili në afatin kalimtar të janarit u rikthye në skuadrën e Dritës, pasi në Feronikel e konsideruan të panevojshëm. Fazliu për "Epokën e re" ka thënë se skuadra gjilanase synon tri pikët e plota. "Sigurisht se do të jetë një ndeshje e fortë ku përballen i pari dhe i dyti. Ne jemi të përgatitur dhe motivuar pas tri fitoreve radhazi dhe shkojmë në Suharekë për fitore. Do të angazhohemi që të vazhdojmë këtë seri pozitive, pse jo të marrim vendin e parë në tabelë", ka deklaruar Fazliu. Sot (e mërkurë) zhvillohen edhe tri ndeshje të tjera të xhiros së 21-të dhe takohen: Gjilani-Feronikeli, Trepça '89-Llapi dhe Prishtina-Ferizaj.

**IPKO SUPERLIGA - Java e 21-të**

**Të mërkurën takohen:**
13:00 Ballkani - Drita
13:00 Gjilani - Feronikeli
13:00 Trepça '89 - Llapi
17:00 Prishtina - Ferizaj

**Të enjten takohen:**
13:00 Drenica - Flamurtari
13:00 Vushtrria - Dukagjini

**LIGA E PARË - Java e 19**

**Të mërkurën takohen:**
Vllaznia (P) - Liria
Drenasi - Trepça
KEK-u - Vitia
Malisheva - Dardana
Ramiz Sadiku - Istogu
2 Korriku - Vëllaznimi
Besa - Arbëria
Onix - Ulpiana

## SHKURT

### Kelmendi: Të gjithë në Kosovë do t'i bëj krenarë

Ashtu si në Olimpiadën e kaluar në Rio de Janeiro më 2016, edhe në edicionin e kësaj vere Majlinda Kelmendi mbetet shpresa kryesore e shqiptarëve për medalje të artë në Lojërat Olimpike. Përfaqësuesja e delegacionit të Kosovës ishte mes më të vlerësuarve në ceremoninë që organizoi Komiteti Olimpik i Kosovës "Laureatët e vitit 2019" dhe premtoi se do t'i bëjë tifozët krenarë. "Nuk jam tip që jap shumë premtime. Thjesht punoj dhe me sukseset e mia i bëj të ndihen mirë, i bëj të mburren me mua dhe me krejt Kosovën. Ju premtoj se do të punoj, do të përpiqem ta jap maksimumin dhe mos t'i zhgënjej dhe t'i bëj të ndihen krenarë me mua", ka thënë Kelmendi.

### Hidhet shorti për fazën çerekfinale të Kupës në hendboll

Të martën është hedhur shorti për fazën çerekfinale të Kupës së Kosovës në hendboll. Në konkurrencë të meshkujve në çerekfinale do të ballafaqohen Vëllaznimi - Trepça, Vushtrria - Kastrioti, Besa Famgas - Zhegra dhe Prishtina - Drenica. Ndërkohë në konkurrencë të femrave do të përballen Kastrioti - Shqiponja, Istogu - Drita, Vushtrria - Ferizaj dhe Vëllaznimi - Prishtina. Ndeshjet çerekfinale do të luhen më 11 e 12 mars.

### Fillon shitja e biletave për ndeshjen Maqedoni - Kosovë

Ka filluar edhe zyrtarisht shitja e biletave për përballjen në mes të Përfaqësueses së Maqedonisë së Veriut dhe Përfaqësueses së Kosovës në kuadër të "play-off"-it në Ligën e Kombeve. Kjo ndeshje zhvillohet më 26 mars në Arenën Kombëtare "Todor Proeski", e që më pas do ta presin fituesin e përballjes tjetër Gjeorgji - Bjellorusi, për t'u takuar në finale. Biletat për ulëset jugore dhe veriore do të shiten për 5 euro dhe 6 euro. Një person mund të blejë një biletë duke paraqitur një dokument identifikimi (ID e vlefshme ose pasaportë). Vendet ku shiten biletat: Arena Kombëtare "Todor Proeski", TA Globe - Ohër, TA Bran - Pastep, Bar koncepti - Strumica, Kafe Symbol - Shtip, Literatura - Manastir, Kiosk Korso - Të pasigurt, Uni Son - Velesi, Duhani Leni + - Gjevgjeli, Libero Travel - Brakes.

## Kosova nuk ndryshon në renditjen e FIBA-s

Prishtinë, 3 mars - FIBA ka publikuar renditjen më të re, ku Kosova edhe më tutje vazhdon të jetë në vendin e 69 në botë. "Dardanët" në muajin shkurt fituan ndaj Islandës me rezultat 80:78 dhe Luksemburgut në udhëtim 80:84. Megjithatë, nuk kanë lëvizur në renditjen më të re të publikuar nga shtëpia botërore e basketbollit. Kundërshtarja e Kosovës në grup, Islanda, ndodhet në vendin e 46-të, duke mos lëvizur nga renditja. Sllovakia ka përparuar për dy vende dhe tashmë ndodhet në vendin e 66-të, e Luksemburgu renditet në vendin e 77-të, duke u ngritur për nëntë vende, edhe pse humbi nga Sllovakia dhe Kosova. Sa iu përket shteteve evropiane, Kosova ndodhet në vendin e 37-të ashtu siç ishte në renditjen e kaluar. Në renditjen e përgjithshme, ShBA-ja renditet në vendin e parë, duke u pasuar nga Spanja dhe Australia.



## Skitarët e Kosovës fitojnë pesë medalje në Mavrovë



**PRISHTINË, 3 MARS -** Skitarët e rinj të Kosovës kanë fituar pesë medalje në garën e Federatës Ndërkombëtare të Skitarisë (FIS) që po mbahet për U-14 dhe U-16 në Mavrovë të Maqedonisë së Veriut, disiplina e sllallomit. Lirika Deva fitoi medaljen e artë në grupmoshën U-14 me kohë 1.00:60 minuta nga të dyja lëshimet, ndërsa e dyta doli Elena Hoxha me kohë 1.07:08 minuta. Në grupmoshën e njëjtë, por tek meshkujt, Klos Vokshi zuri vendin e parë me kohë 1:04.22 minuta, ndërsa Dren Spahiut (U16) nuk i priu fati, pasi doli nga shtegu. Në grupmoshën U-16, Era Deva zuri vendin e parë me kohë 1:07.38 minuta nga të dyja lëshimet, ndërsa Klana Kryeziu doli e dyta me kohë 1:08.07 minuta. Etna Nura ishte e pafat, pasi doli nga shtegu.

# 'Dardanet' zbarkuan në Gjermani për rezultat pozitiv ndaj Rusisë

**PRISHTINË, 3 MARS -** Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave të martën ka arritur në Wiesbaden të Gjermanisë, aty ku të premten në orën 18:00 do ta zhvillojë ndeshjen kualifikuese për "Euro 2021" kundër Rusisë. Ekspedita e Kosovës me lojtare nga kampionati vendor në krye me anëtaren e KE të FFK-së, Vjollcë Krasniqi dhe përzgjedhësen Afërdita Fazlija të martën mbërriti në Gjermani, derisa pjesa tjetër e lojtareve do t'i bashkohet grupit në Wiesbaden. "Dardanet" do t'i zhvillojnë dy stërvitje sot (e mërkurë) si dhe një të enjten. "Synimin ynë është për një prezantim sa më të mirë dhe për rezultat pozitiv, por se jemi të vetëdijshme për cilësinë e kundërshtarit", ka thënë përzgjedhësja e Kosovës, Afërdita Fazlija.



Problem për ekipin e "Dardaneve" paraqet fakti që shumica e lojtareve ende nuk i kanë filluar garat e stinorit pranveror me skuadrat e tyre, derisa edhe kampionati vendor ka filluar vetëm në fundjavën që e lamë pas. Kosova deri më tash ka zhvilluar tri ndeshje në kuadër të këtyre kualifikimeve, duke realizuar dy fitore e një humbje. "Dardanet" në Wiesbaden shpresojnë ta kenë edhe përkrahjen e madhe të bashkatdhetarëve tanë, të cilët çdoherë në raste të tilla kanë qenë përkrahës dhe motivues të ekipeve tona kombëtare.

**LISTA E FUTBOLLISTEVE**

Besarta Leci, Modesta Uka, Florentina Kolgeci, Fjolla Shala, Feride Kastrati, Edona Kryeziu, Donjeta Halilaj, Valentina Limani, Besarta Hisenaj, Flutër Agaj, Flaka Aslanaj, Besiana Reçica, Leonora Ejupi, Erëleta Memeti, Alberina Syla, Blerta Smaili, Liridonë Syla, Kaltrina Biqkaj, Blerta Shala, Lavdije Behramaj, Fleta Musaj, Edona Kastrati, Besijana Pireci.

# Suprizohen ekipet e mëdha në NBA

**MIAMI, 3 MARS -** Miami surprizon kryesuesit e Milwaukee, duke fituar me rezultat 105-89, humbja më e thellë e skuadrës së Bucksit këtë sezon. Lojë e mirë kolektive e Miamit, me 6 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë, ndërkohë që 47 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. Një ndeshje "normale" për Antetokounmpo, me 13 pikë e 15 rebounde, duke mos dhënë atë që pritej. Fiton edhe ekipi i Indianas, që mundi me shifrat 116-111 San Antonion, ndeshje me rivalitet dhe emocione në fund. Brogdon me 26 pikë e Warreni me 23 bënë diferencën për Indianan në këtë sfidë. Në sekondat e fundit humbet edhe Houstoni, që u mposht me rezultat 125-123 nga New Yorku. Ndeshje e dominuar nga vendësit, që u shkëputën deri në 20 pikë (Barrett 27 pikë shënuesi më i mirë), ndërkohë që 59 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Në kahun tjetër, Hardeni e Westbrooku realizuan 59 pikë së




bashku, por që mbetën për statistikë. Skuadra e Utah Jazzit, falë 28 pikëve të Bogdanoviçit, mundi 126-113 Clevelandin, ndërsa Memphisi triumfoi 127-88 ndaj Atlantas, ndeshje ku 9 lojtarë të ekipit mik realizuan mbi 10 pikë.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Cleveland - Utah Jazz | 113-126 |
| New York - Houston | 125-123 |
| Orlando - Portland | 107-130 |
| Atlanta - Memphis | 88-127 |
| Miami - Milwaukee | 105-89 |
| Chicago - Dallas | 109-107 |
| San Antonio - Indiana | 111-116 |

## SHKURT

### KB Rahoveci tërhiqet nga Liga Ballkanike

KB Rahoveci ka vendosur të tërhiqet nga Ballkan Liga për shkak të shumë pakënaqësive rreth organizimit të këtij turneu. Këtë e ka konfirmuar për "lajmi.net" anëtari i bordit, Bekim Hoxha, i cila tha se deri te ky vendim kanë ardhur në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit të Kosovës. "Kemi bërë kërkesë që të tërhiqemi nga Ballkan Liga. Kemi marrë letër mbështetëse nga Federata e Basketbollit të Kosovës. Në konsultim me Federatën e Basketbollit kemi marrë vendim që të tërhiqemi nga BIBL për shkak të shumë parregullsive dhe dyshimeve tona", ka thënë Hoxha. "Na është konfirmuar se do të jenë gjashtë ekipe, pastaj në raundin e dytë ndryshoi gjithçka. Kjo na ka shtyrë të marrim këtë vendim në proporcion me rregullat e garës", ka shtuar Hoxha. Rahoveci nuk shijoi sezon të mirë në BIBL, duke u renditur në pozitën e fundit me tri fitore dhe gjashtë humbje. Ndeshja vendimtare me Pejën, e planifikuar të zhvillohet këtë të mërkurë në 'Karagaç' kundër vreshtarëve, me shumë gjasë do të anulohet.

### Cagliari shkarkon trajnerin

Cagliari e nisi shumë mirë sezonin aktual, duke u konsideruar nga shumë njerëz si surpriza e Serisë A për këtë sezon. Megjithatë, skuadra pësoi një rënie të ndjeshme, teksa në 12 ndeshjet e fundit nuk njeh asnjë fitore. Pikërisht nga kjo situatë e skuadrës ka pësuar trajneri Rolando Maran. Drejtuesit e klubit kanë marrë vendimin që të shkarkojnë nga drejtimi i ekipit teknikun italian, duke e quajtur atë fajtorin për rezultatet e fundit. Në 12 ndeshjet e fundit Cagliari ka grumbulluar 4 barazime dhe 8 humbje, teksa kjo e ka bërë të pashmangshëm shkarkimin e trajnerit Maran.

### Guardiola: Ka përfunduar gara për titull

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, e konsideron të mbyllur garën për titull në Angli. Diferenca prej 22 pikësh, gjithsesi, është e parikuperueshme për "qytetarët" e vendit të dytë. "Kampionati ka mbaruar dhe Liverpooli e meriton titullin. Pas kaq shumë lojërave, nëse avantazhi është ai që është, kjo ndodh sepse të kuqtë e meritojnë titullin. Do të doja të isha më afër Liverpoolit në klasifikim, por ky është realiteti. Tani na duhet të vijojmë me ritmin më të mirë të mundshëm, kemi ende shanse për trofe në FA Cup dhe Ligën e Kampionëve", ka thënë Guardiola.

### Barça ofron 70 milionë euro dhe dy futbollistë për Martinezin

Barcelona për sezonin e ardhshëm planifikon transferimin e sulmuesit të Interit, Lautaro Martinezin. Klauzola e sulmuesit është 111 milionë euro, e cila është e vlefshme nga 1 deri më 15 korrik. Barça nuk është e gatshme të paguajë këtë shumë, por po përgatit ofertën prej 70 milionë eurosh dhe dy futbollistët Arturo Vidal dhe Nelson Semedo. I pari vlerësohet 20 milionë dhe i dyti 40 milionë euro.

### Vdekja e Bryantit, hetohen 8 policë

Tetë policë të qarkut të Los Angelesit do të përballen me një hetim disiplinor për shpërndarjen e fotove të frikshme të marra nga skena e rrëzimit të helikopterit në të cilin humbën jetën 9 persona, midis tyre dhe basketbollisti i njohur Kobe Brayant dhe vajza e tij 13-vjeçare. Sherifi i metropolit të Kalifornisë, Alex Villanueva, është shprehur se ndihet i shkatërruar për shkeljen e intimitetit të viktimave dhe siguroi që agjentët me urdhër të tij i kanë fshirë të gjitha imazhet nga telefonat e tyre. Alex shpjegoi se në vendin e rrëzimit të avionit në malet e Calabasas ishin të autorizuar vetëm dy grupe njerëzish për të bërë foto. Stafi legal i Zyrës Mjekësore dhe hetuesit nga Bordi Kombëtar i Sigurisë së Transportit. Por, disa nga bashkëpunëtorët e tij i kanë shpërndarë brenda dhe jashtë departamentit. Incidenti u raportua për herë të parë nga 'Los Angeles Time' dhe avokatët e familjes së viktimave kanë kërkuar dëmin maksimal dhe hetim të brendshëm për tetë agjentët.



| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | ZVARRANIK I MADH (shq.) | LLOJ PIJE FRESKUESE E ATHËT | NITROGJEN | REPUBLIC OF TEXAS | INDIUM | METAL ME SHKËLQIM SI TË ARGJENDIT | ZANORE | ISH SHEFI I CIA-së XHORXH | KASOLLE PËR GJËNË E GJALLË | EPOKA E RE | E VËNË NË SITË |
| | | | | | | VEGËL MUZIKORE | | | | | | | | | | EMPOLI / MALLKIMI NGA KISHA | |
| | | | | | | QYTET I LASHTË NË ILIRI / KADIFE | | | | | | | E NDESH / SKANDAL (sh.shq.) | | | | |
| | | | | | | → | | | | | LIGJI (vjet.) / AKTORJA ANAGNOSTI | | | | | | |
| | | | | | | PA NDONJË DOBI | | | | KUMTIM I GJERË ME SHKRIM, QË MBAHET PARA NJË MBLEDHJEJE / "MESINA" | | | | | | | |
| | | | | | | OLIVER NEUVILLE | | | PJESË E LIMANIT (sh.shq.) / POLITIKAN & ARKEOLOG SHQIPTAR | | | | | | "TUNIZIA" / VEÇORI THELBËSORE E NJË DUKURIE | | |
| | | | | | | BANOR I NJË SHTETI SKANDINAV | | | | | | BASHKËTING. / BAKRI | | KA, DEM / GOTË PREJ METALI | | | |
| | | | | | | MENDIM | | | | PUNIM I ARËS / ABBOTT MEDICAL OPTICS | | | | | | | GRADË USHTARAKE (shq.) |
| EPOKA E RE | SUPER MODELJA & AKTORJA FRANCEZE NË FOTO | KRYEQYTET I NJË SHTETI EVROPIANO-AZIATIK (pashq.) | QË SHEH VETËM DOBINË E ÇASTIT | RENS ISTVUD | SHKOJMË, ECIN (bised.) | NJOLLA / SHTAGA | | | | | FAZAT / VARG MALESH TË LARTA DHE TË ASHPRA | | | | | | |
| DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË | | | | | | | | KRYEHOXHË / LARTËSIMI I ZËRIT DUKE THEKSUAR QARTË ÇDO FJALË | | | | | NË ÇFARË MASE / SAN ANTONIO | | | ZANORE / PËREMËR PRONOR | |
| SENDE QË ÇMOHEN PËR VJETËRSI / AKTORI I FAMSHËM .... ÇEN | | | | | | | ZBUKUROJ, HIJESHOJ / ZANORE | | | | | | | RITUAL / KËMBËZ SHKALLE, SHKALLARE | | | |
| → | | | | VENDLINDJA E ODISEUT / OHIO STATE UNIVERSITY | | | | | | PRAGA / HIGHLANDER YOUTH RECREATION | | ALI PODRIMJA / KAFSHË E MADHE E MISHNGRËNË-SE (shq.) | | | MARC ANTHONY / NJERI I POSHTËR, I PANDERSHËM E I PACIPË | | |
| TRISKA, KUPONI | | | | | | | FUTBOLLISTI ARGJENTINAS ..... DI MARIA (shqip.) / SKAJI, QOSHJA | | | | | | PRINC ARAB / VENDI ME VATHË E ME KASOLLE PËR BAGËTITË | | | | |
| REGJISORJA SHQIPTARE ELEZI | | | | | KLUB FUTBOLLI FRANCEZ (origj.) | | | | | | MJESHTËR (vjet.) / SISTEM NGROHJEJE, RADIATOR PËR NGROHJE | | | | | ISTRES / FLORA OSMANI | |
| DEUT MUZIKOR KONTROVERS (fem.) | | | | | LLOJ GODITJE NË BOKS NGA LART POSHTË / SAHAT | | | | | | | | | SAMI FRASHËRI | | | ISHULL NË SHQIPËRI (pashq.) |
| ZANORE | | AUSTRIA / DREJTUESI I EKIPIT MILAN ADRIANO | | ZANORE / EMËR MASHKULLI MYSLIMAN | | KLUB FUTBOLLI SUEDEZ / FRYMA | | | | TENISTJA KURNIKOVA / LLOJ GURI I ÇMUAR PREJ TË CILIT BËHET STOLI | | | | PRODUKT I QUMËSHTIT / SHKRONJA TË NJËJTA | | | |
| BUJQËSORE | | | | | | | XHUDISTJA KELMENDI / REKUIZITË SPORTIVE | | | | | | | | | ZANORE / TERRITOR I IMAMIT | |
| KORÇA, APOLLONIA | | | ISH PRESIDENTI FINLANDEZ AHTISARI / FUQI, FORCË | | | | | | DY ZANORE / ANDORA | | | PATRIOTI SEFERI / ALEN NURI | | | | | |
| GJASHTARE | | | | | AMERICA ONLINE / KËNGËTARJA JONË BAJRAMI | | | AMERICAN SOCIETY REGIONAL ANESTHESIA / ISH BEND MUZIKOR BRITANIK | | | | | TEMË E NDALUAR | MA JEP TEATËR NË PRISHTINË | | | |
| KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE (shqip.) | | | | | | PETRO MARKO / HENDEK I VOGËL | | | FUTBOLLISTI PORTUGEZ JOAO ..... / RADIUM | | | | | | ALESANDRO NESTA / AMPER, SILIC | | |
| SHKOP I BILARDOS | | | | DY BASHKËTINGËLLORE / SENEGALI, RUANDA | | | EMËR YNI MASHKULLI / "SOMALIA" | | | | | AKTORI HOLLIVUDIAN SANDLER / VARIOLË | | | | | NORA ISTREFI |
| KËNGËTARE ME FAMË BOTËRORE | | | | | | | | | | QYTET NË SHQIPËRI / ZANORE | | | | | | | |
| EPOKA E RE | I PËRZIEN | | | | | | | | BISHË MALI | | | | | INTENSITET, TITAN | | | |

Republika e Kosovës

**Komuna e Malishevës**

**Drejtoria për Arsim dhe Edukim**

*Nr: 11/201*
*Më:03.03.2020*

*Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ ( MPMS)Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:*

## KONKURS

*Për plotësimin e vendeve të punës*

*Viti shkollor 2019/2020*

| Nr | Niveli, Shkolla | Pozita | Vendi i lirë/zëvendësim | Numri i pozitave | orë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SHFMU" Gjergj Kastrioti" në Llazicë | Mësimdhënës i lëndës së gjuhës shqipe | Me kohë të caktuar deri sa të kthehet punëtori në vendin e tij të punës | 1 | 15 |

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal(letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit(ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)
- certifikata e lindjes

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të lëndës së gjuhës shqipe kërkohet kualifikimet: **Fakulteti i Edukimit- programi fillor; Niveli master arsimor-Fakulteti i Edukimit ( 300 ECTS); Sistemi katërvjeçar; baçelor(katërvjeçar 240 ECTS).** ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

**III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente( jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

**Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.**

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në ueb- faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **03.03.2020 më datën:17.03.2020**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

---

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Thesari -Trezor - Treasure
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: Thesari — Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 30
Nr. i fqeve / Broj stranica / No. pages: 1 — Data / Datum / Date: 03. 03. 2020
Dalëse — PRISHTINË/A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
**Ministria e Financave dhe Transfereve**
**Ministarstvo za Finansije i Transfere – Ministry of Finance and Transfers**
*Thesari i Kosovës – Trezor Kosova – Treasury of Kosovo*

### Shpallje e Ankandit të Letrave me Vlerë KV002-20

| | |
|---|---|
| Afati dhe Lloji | 3 Vjeçar – Obligacion Qeveritar |
| Shuma e Ofruar | €30,000,000 |
| Kodi i Instrumentit | KV1214721476 |
| Data e Ankandit | 10.03.2020 |
| Data e Shlyerjes | 11.03.2020 |
| Data e Maturimit | 11.03.2023 |
| Mekanizmi i Çmimit | Çmime të Shumëfishta |

Shënim: Qeveria e Republikës së Kosovës rezervon të drejtën për ri-blerje të kësaj Letre me Vlerë nëpërmjet operacioneve të përcaktuara në Rregulloren MF-BQK Nr.01/2014 Për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

### Announcement of Securities Auction KV002-20

| | |
|---|---|
| Term and Type | 3 Years – Government Bond |
| Offering Amount | €30,000,000 |
| Instrument Code | KV1214721476 |
| Auction Date | 10.03.2020 |
| Settlement Date | 11.03.2020 |
| Maturity Date | 11.03.2023 |
| Pricing Mechanism | Multiple Price |

Note: The Government of the Republic of Kosovo reserves the right to re-purchase this Issue through operations defined in the Regulation MoF-CBK No. 01/2014 for the Primary and Secondary Market of Government Securities of the Republic of Kosova.

### Objava Aukcije Hartija od Vrednosti KV002-20

| | |
|---|---|
| Rok i Tip | 3 Godina – Drzavna Obveznice |
| Ponuđeni Iznos | €30,000,000 |
| Instrument kod | KV1214721476 |
| Datum Aukcije | 10.03.2020 |
| Datum Poravnanja | 11.03.2020 |
| Datum Dospeća | 11.03.2023 |
| Mehanizam Cene | Visestruka Cena |

Napomena: Vlada Republike Kosova ima pravo da ponovo otkupi obveznice preko operacija definisanih u Uredbu MF-CBK Br.01/2014 o Primarnom i Sekundarnom Tržištu Izdavanja Hartija od Vrednosti Vlade Republike Kosova.

BQK/CBK Tel.: (038) 222-055 ext. 245

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Ahmet Ismaili

---

Ne baze te akteve te brendshme të kompanisë dhe te planit dinamik te punës për vitin 2020, biznesi Ardiana R. Hajdini B.I.me NUI: 811371905 me adrës Rr.Don Bosko pn. Prishtinë, bene:

## SHPALLJE PUBLIKE

## Për furnizim me fidane te rrushit

Biznesi Ardiana R. Hajdini B.I. me NUI: 811371905 me adrës Rr.Don Bosko pn. Prishtinë, shpall Tenderin për furnizim me fidane te rrushi te certifikuara nga një vend i BE-se.

Ftojmë te gjitha kompanitë vendore dhe ndërkombëtare të interesuar qe bëjnë prodhimin dhe tregtimin e fidanëve te rrushit, qe te marrin pjesë ne këtë shpallje - tender.

Kriter bazë për plotësimin e kushteve minimale për pjesëmarrje në tender dhe ata të përzgjedhur është:

1. Te jetë kompani e licencuar nga MBPZHR si prodhues ose importues i materialit fidanor të rrushit vetëm për firmat vendore,
2. Te ofroj dëshmi qe materiali fidanor është me origjin nga një vend i BE-se i prodhuar dhe i certifikuar,
3. Te ofroj certifikatë fito sanitarë për gjendjen shëndetësorë për materialin fidanor,
4. Dokumentet e biznesit sipas dosjes se tenderit,

Te drejtë aplikimi kanë të gjitha firmat vendore dhe ndërkombëtarë, të gjitha kompanitë qe janë te licencuara për prodhim dhe tregtimin e fidanëve te rrushit
Te dhënat e detajuara mbi sasinë dhe llojin e fidanëve i gjeni ne dosjen e tenderit.
Data e shpalljes: 04.03.2020 - Data e mbylljes: 14.03.2020
Informacionin e plote mund ta gjeni ne dosjen e tenderit me rastin e tërheqjes së tij në formë elektronike përmes kërkesës në E-mail: lindamaloku14@gmail.com si dhe për informacione shtesë kontaktoni në nr. të tel: 045462917.

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
K.R.M. "ÇABRATI"
Tel.+381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail. info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

Në bazë të nenit 21 të Ligjit numër 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 15.06.2008), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-111 (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 30.05.2012), nenit 21 paragrafi 21.3.6 të Statutit të KRM "Çabrati" Sh.A., Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 28.02.2020, vendosi që me datë 04.03.2020 të rishpall ketë:

**KONKURS**

**Pozita**: Kryeshef Ekzekutiv
**I përgjigjet**: Bordit të Drejtorëve
**Vendi**: Gjakovë

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**
Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nenit 17.3 pika (a), dhe (b), detyrimit të dhënies së deklaratës nën betim sipas nenit 17.5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe se kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë së paku 5 vite përvojë në nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulencë në biznes, industri ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së për së paku 5 vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtarë i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushte me veprimtarinë afariste të NP-së;
- të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- të mos jetë i dënuar ose nën hetime;
- një program zhvillimor për kompaninë.

**Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:**
- Ne pajtim me Ligjin, Kodin e Etikes, Qeverisjen Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe Statutin, duke iu nënshtruar vetëm përkufizimeve të BD ka autoritetin të lidhë kontrata për Kompaninë;
- Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e Kompanisë të cilat nuk janë në përgjegjësi të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm do të vendosen sipas direktivave dhe përgjegjësisë së Kryeshefit Ekzekutiv;
- Këshillon dhe asiston Bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë së kompanisë si dhe planet e saja strategjike afatgjate;
- I ofron Bordit të Drejtorëve kurdo që është e nevojshme dhe së paku një herë në tre muaj raporte për transaksionet kryesore të ndërmarra nga kompania dhe për vendimet kryesore të ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve të kompanisë;
- Ofron Bordit të Drejtorëve rregullisht së paku çdo tre muaj raportet e matjes së performancës së kompanisë;
- Themelon dhe rishikon strukturën organizative të kompanisë, si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të punësuarve në kompani;
- I ofron Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet;
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme.

**Paga**: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

**Procedura e aplikimit:**
Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV-ja (Biografia);
- Letërnjoftimi - kopje;
- Letër motivimi;
- Deklarata nën betim;
- Diplomën e kualifikimit (minimum universitare) – kopje;
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më te vjetër se 3 muaj – origjinale;
- Programi zhvillimor për kompaninë.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitën: Kryeshef Ekzekutiv i KRM "Çabrati" Sh.A.".
Afati i dorëzimit është nga data 04.03.2020 deri me datë 18.03.2020 në ora 16.00.

Kërkesat e dorëzuara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen nga Bordi i Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
K.R.M. "ÇABRATI"
Tel.+381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail. info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

Na osnovu člana 21. Zakona br 03 / L-087 o Javnim Preduzećima (objavljen u Službenom Glasniku od 15.06.2008), izmenjen i dopunjen Zakonom 04 / L-111 (objavljena u Službenom Glasniku od 30/05 .2012), člana 21, stav 21.3.6 Statuta RKO "Čabrati" AD , Upravni Odbor na sednici održanoj dana 28.02.2020, je odlučio da 04.03.2020 ponovo raspisuje:

**KONKURS**

**Pozicija**: Glavni izvršni direktor
**Odgovara**: Upravnom Odboru
**Mesto**: Đakovica

**Uslovi i potrebne kvalifikacije :**
Upravni Odbor želi da se osigura da svi potencijalni kandidati su osobe sa priznatim integritetom koji ispunjavaju uslove kvalifikacije prema članu 17.1, kao i da zadovoljavaju kriterijume o nezavisnosti prema članu 17.2 tacke (d), (f), (J) (k) i (l) Člana 17.3 tačka (a) i (b) obaveze izjave pod zakletvom prema članu 17.5 Zakona o Javnim Preduzećima i da imaju odgovarajuću stručnu spremu i obrazovanje za poziciju koja je u pitanju.
Pored ovih opštih uslova kandidati moraju ispunjavati i ove sledeće posebne uslove:

- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva na visokom nivou menađmenta u oblasti poslovnog menađmenta, korporativnih finansija, finansija, upravljanje trezora, banke, konsultantske usluge u poslovanju, industriji ili bilo koje druge oblasti nauke koji se bavi aktivnošću PJ- u trajanju od najmanje pet godina, da je bio javni računovođa, kvalifikovani pravnik ili kvalifikovani pripadnik bilo koje druge profesije koja je usko povezana sa poslovnim aktivnostima PJ;
- da ima visok moralni i profesionalni integritet;
- da ima dokazanu sposobnost za upravljanje;
- poznavanje stranih jezika je prednost;
- da nije osuđivan, ili pod istragom;
- jedan program razvoja za kompaniju.

**Glavne obaveze i odgovornosti:**
- U skladu sa Zakonom, Etičkog kodeksa, Korporativnog upravljanja, Javnih Preduzeća i Statuta, podležuči samo definicijama UO ima ovlašćenje da sklapa ugovore za preduzeća;
- Sva pitanja u vezi sa poslovanjem Kompanije koje nisu u nadležnosti Skupštine Akcionara, Upravnog Odbora, Komisije za Reviziju ili službenika za Internu Reviziju će biti stavljeni pod direktivama i odgovornosti glavnog izvršnog službenika ;
- Savetuje i pomaže Upravni Odbor u određivanju strategije kompanije i njenih dugoročnih strateških planova;
- Pruža Upravnom Odboru po potrebi, a najmanje jednom u tri meseca izveštaj o velikim transakcijama od strane kompanije i glavne odluke donete od strane rukovodstva u vezi sa vođenjem poslovanja i kompanije radova ;
- Pruža Upravnom Odboru redovno barem svakih tri meseca izvještaj za merenje performansi kompanije;
- Uspostavlja i pregleđuje organizacionu strukturu kompanije, kao i interkonekciji moći između lidera i zaposlenih u kompaniji;
- Pruža Komisiji za reviziju sve informacije i pomoć koja može biti potrebna;
- Učestvuje u svim opštim sastancima.

**Plata**: U skladu sa politikom odobrene naknade od strane Upravnog odbora.

**Procedura apliciranja:**
Aplikaciji moraju biti priložena i ova dokumenta:
- CV- (Biografija);
- Lična karta - kopija;
- Motivaciono pismo;
- Izjava pod zakletvom;
- Diplomu kvalifikacije (minimum univerzitetsku) – kopiju;
- Dokaz da niste pod istragom, ne stariji od 3 meseca-original;
- Program razvoja za kompaniju.

Podnošenje prijave i relevantne dokumentacije vrši se kod Sekretarijata Kompanije Društva u zatvorenoj koverti sa naznakom: "Za poziciju: Izvršni Direktor RKO" Čabrati "AD".
Krajnji rok za podnošenje je datum od 04.03.2020 do 18.03.2020 u 16.00 sati

Zahtevi koji pristižu nakon zadnjeg datuma i nepotpuni zahtevi neće biti prihvaćeni od strane Upravnog Odbora. Formalni intervjui i procene će se vršiti nakon isteka roka za prijavu, dok PJ zadržava pravo formiranja kratke liste sa kandidatima koji apliciraju.

K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudriniibardhe.com

Në bazë të nenit, 21 paragrafi 21.4 , të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.03/L-087, si dhe Plotësim Ndryshimi i Ligjit mbi NP Nr.04/L-111, Ligji i punës Nr.03/L-212 nenit 8, si dhe Kodi i Etikes dhe Qeverisjes Korporative.
Bordi i Drejtorëve të K.R.U "Drini i Bardhë" SH.A në mbledhjen e mbajtur me 25.02.2020,vendosi të publikoi ketë:

## KONKURS

**Për plotësimin e pozitës:**

**1. Zyrtar Kryesor Financiar i Kompanisë**
**I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.
**Vendi i Punës:** Pejë.
**Paga:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.
**Kohëzgjatja e emërimit:** Mandati për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar është 3 vjeçar.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

-Zyrtari Kryesor Financier (ZKF) do të menaxhoj çështjet financiare të Kompanisë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE dhe Komitetit të Auditimit në përputhshmëri me legjislacionin primar dhe sekondar për menaxhimin e ndërmarrjeve publike,
-Në varësi të kufizimeve të vëna nga Bordi i Drejtoreve, do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare në Kompani dhe do të jetë përgjegjës për:
-Menaxhimin financiar të Ndërmarrjes.
-Mirëmbajtjen e llogarisë se Kompanisë të azhurnuar dhe të saktë;
-Përgatitë të dhënat e Kompanisë për auditim në fund të vitit;
-Menaxhon thesarin e kompanisë, vendos dhe përgatitë buxhetin dhe çfarëdo detyre tjetër financiare të përcaktuar nga KE apo BD.
-Mbajtja e kontabilitetit të Kompanisë sipas standardeve, raporton dhe përpilon pasqyrat financiare të Kompanisë; Përpilon planin financiar të punës;
-Kontribuon dhe përkujdesët për përgatitjen dhe harton më kohë raportet financiare periodike dhe përfundimtare;
-Kryen dhe punë tjera të cilat për nga natyra i përkasin kësaj natyre organizative të cilat kërkohen nga Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë, apo BD.

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), të Ligjit për Ndërmarrje Publike, të kenë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë,
Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:
- të kenë diplome universitare nga fusha ekonomike,
- të ketë së paku 5 vjet përvojë punë në menaxhim të financave publike apo në korporata,
- të jete i certifikuar nga ndonjë autoritet financiar i licencuar në sferën e kontabilitetit apo raportimeve financiare (ka përparësi),
- të ketë integritet të lartë moral e profesional,
- të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim financiar,
- të njohë standardet e kontabilitetit dhe raportimeve financiare,
- njohja e gjuhëve të huaja është përparësi,
- të mos jetë i dënuar ose nën hetime.
Aplikacionit për pozitën e ZKF-së duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- Kërkesën,
- CV-ne (Biografinë),
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Letër motivimin,
- Deklaratën nën betim,
- Diplomën e fakultetit – kopje të Noterizuar,
- Certifikatë që nuk është nënë hetime dhe
- Dëshminë e përvojës së punës.

**Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

Duhet të ketë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike financiare të ndërmarrjes, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të menaxhimit financiar, standardeve të kontabilitetit dhe raportimeve financiare, aftësi të mira të komunikimit, interpretimeve financiare dhe negocimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes financiare dhe ofrimin e opsioneve, njohuri të avancuara në programet e kontabilitetit, së paku 5 vjet përvojë pune profesionale në nivelin drejtues dhe në fusha që ndërlidhen me menaxhimin financiar ne institucione apo ndërmarrje publike.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim për pozitën e ZKF-së:** Sipas këtij konkursi kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Procedura për aplikim:**

Aplikacionet e kompletuara sipas këtij konkursi dërgohen në Zyrën e Asistentes Administrative NP. K.R.U "Drini i Bardhë" SH.A në adresën Rr." Mbretëresha Teutë" Nr.85 Pejë, konkursi është i hapur nga data 03.03.2020, aplikacionet mund të dorëzohen nga ora 8:00 deri në ora ora16:00.

**Paraqitja e kërkesave:**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. rast të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ntaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim kumentet origjinale.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Labinot Musliu shpall të pavlefshme katër dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

▶ Driton Zhitia shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përballë "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.




**Salloni i Depilimit 'Lume's Details' në Prishtinë kërkon një praktikante e cila pastaj mund të punësohet me pagesë nëse tregon rezultat të mirë gjatë kohës së praktikës.**
**Të interesuarat mund të paraqiten në këta numra kontaktues: 045681898 dhe 044900978**




Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

**Interesimi i juaj - përkushtimi ynë. Eksperienca jonë - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 02.03. 2020 deri më 20.03.2020**

